

PËRMIRËSIMI I PËRFSHIRJES SË KOMUNITETIT SERB TË KOSOVËS NË AKTIVITETET EKONOMIKE NË KOSOVË

Mbështetur
nga Zyra
Zvicerane për
Bashkëpunim
në Kosovë



Riinvest Institute
MARS 2012

**PËRMIRËSIMI I
PËRFSHIRJES
SË KOMUNITETIT
SERB TË
KOSOVËS NË
AKTIVITETET
EKONOMIKE
NË KOSOVË**

Prishtinë, Mars 2012

Publikimi i raportit "Ngritja e Përfshirjes së Komunitetit të Biznesit të Serbëve të Kosovës në Aktivitetet Ekonomike në Kosovë" është i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim Kosovë.

Deklaratë mohimi: Këndvështrimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmëri ato të Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Përgatitur nga:

RIINVEST INSTITUTE:

Alban Zogaj, Fisnik Reçica, Dita Jaka, Alban Hashani,
Lumir Abdixhiku, Diellza Gashi, Etida Zeka.



Partner i Konsorciumit:
AVENIJA: Gordana Đorić.



Konsulenti i SDC-së: Marcus Jenal
Konsulenti vendor: Muhamet Sadiku

Botuar nga

RIINVEST INSTITUTE

Universiteti AAB-RIINVEST, Ndërtesa II, Kati 4
Zona Industriale, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: ++ 381(0)38 601320; 601321
Fax: ++ 381(0)38 601322
www.riinvestinstitute.org

Parathënie

Në vitin 2012 Zvicra shënoi vitin e trembëdhjetë të prezencës së saj në Kosovë. Ajo që fillimisht filloi si ndihmë humanitare, më vonë çoi drejt njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Zvicra dhe themelimit të lidhjeve diplomatike me këtë shtet të ri, si edhe themelimit të bashkëpunimit zhvillimor. Agjenda e përgjithshme e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë ka qenë t'i përkrah tranzicionin gjithëpërfshirës shoqëror të Kosovës në ekonominë e tregut dhe shoqërinë demokratike. Si e tillë, Zvicra ka ndërmarrë iniciativa të ndryshme për ta fuqizuar zhvillimin ekonomik dhe punësimin e qëndrueshëm. Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë ka përcaktuar një agjendë ambicioze për zhvillim të integruar, në mënyrë që të ndërtohet një shoqëri përparimtare përmes aktiviteteve të biznesit dhe të promovohet bashkëpunimi në mes të gjitha komuniteteve.

Në mënyrë që të fuqizohet ekonomia e integruar e tregut në Kosovë është thelbësore të promovohet pjesëmarrja socio-ekonomike e pakicave në komunitetet e tyre përkatëse. Pjesëmarrja e akterëve të biznesit që kanë potencial për ngritje dhe zhvillim ekonomik është një domosdoshmëri. Përkrahja e Evropës, Azisë Qendrore, Këshillit të Evropës dhe Divizionit të OSBE-së është thelbësore.

Komuniteti serb është thelbësor për tregti, zhvillim ekonomik dhe padyshim për përparim në Kosovë. Derisa ndodhin më shumë ndërveprime ekonomike, tensionet etnike do të zvogëlohen dhe kështu do t'i kontribuojnë kushteve më të mira për zhvillimin e biznesit në shkallë më të madhe në vend.

Vizioni i cili përfshin përparim ekonomik dhe një shoqëri demokratike dhe multi-etnike duhet të detajohet dhe të bazohet në fakte. Andaj, Zyra Zvicerane për Bashkëpunim konsideron se është me rëndësi shumë të

madhe të bëhet një hulumtim i bizneseve të ndryshme në hapësirat ku jeton shumica e komunitetit serb.

Qëllimi ynë është që ky dokument të kontribuojë për vetëdijesim dhe të kuptuar më thellësisht çështjet e përgjithshme dhe pengesat specifike që e parandalojnë integrimin e komunitetit serb të Kosovës në ekonominë e Kosovës. Rekomandimet e prezantuara në këtë raport do t'u ndihmojnë politikë-bërësve, udhëheqësve të shoqërisë civile, komunitetit të donatorëve dhe biznesit në përpjekjet e tyre për të hartuar dhe zbatuar në mënyrë efektive dhe efikase politika dhe programe. Studimi nuk ka për qëllim të bëhet argument politik.

Ky publikim do ta udhëheqë Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim në përmbushjen e zotimeve të saj me veprime të vazhdueshme dhe efektive në të gjitha fushat. Kjo kërkon zotim afat-gjatë dhe strategji koherente që përfshin sektor të përbashkët etnik privat në mënyrë që të krijohen mundësi për jetesë të qëndrueshme për të gjithë.

Mrs. Krystyna Marty
Ambasadore e Zvicrës
1 Mars, 2012

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport ofron analizë dhe vlerësim të situatës momentale dhe perspektivës së komunitetit të biznesit të serbëve të Kosovës. Ky raport tregon se niveli i pjesëmarrjes së komunitetit serb në jetën ekonomike të Kosovës mbetet shumë i ulët. Në përgjithësi, ka mungesë të qasjes aktive për t'i zvogëluar brengat dhe problemet e komunitetit serb për të marrë pjesë në sistemin ekonomik të Kosovës, dhe ka mungesë të promovimit të politikave përkrahëse për qasje të barabartë të të gjithë qytetarëve në shërbimet publike dhe mundësitë ekonomike. Në lidhje me këtë, Instituti Riinvest dhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) identifikuan nevojën për një studim në mënyrë që të analizohen pengesat, sfidat dhe opsionet për zhvillim të kësaj çështje shumë të ndjeshme, të identifikohen rrethanat aktuale të pjesëmarrjes së komunitetit serb në sistemin e tregut të Kosovës dhe të analizohet nëse ekonomia e Kosovës është diskriminuese ose jo dhe nëse e nxit pjesëmarrjen e mëtutjeshme të komunitetit serb në jetën socio-ekonomike.

Metodat e analizës përfshijnë hulumtimin e materialeve të shkruara, intervista me palët me interes, studime rasti dhe analiza të sistemeve. Raporti gjithashtu paraqet rezultatet nga një hulumtim me 300 biznese, të cilët reflektojnë informata në lidhje me perceptimin e tyre për ndërveprimin e bizneseve ndër-etnike, pengesat dhe mundësitë për zhvillim të biznesit, stimulimet për bashkëpunim biznesi dhe situatën momentale të bizneseve të tyre. Janë mbajtur 100 intervista hulumtuese me biznese të shqiptarëve-K dhe 200 intervista hulumtuese me bizneset e serbëve-K ku 100 biznese u zgjodhën nga Veriu¹ i Kosovës dhe 100 nga pjesa tjetër e vendit.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shumica e bizneseve të serbëve-K janë të vogla. Sipas të dhënave nga hulumtimi, rreth 86% e kompanive të serbëve-K bashkëpunojnë në nivel të ulët apo të mesëm me kompanitë e sh-

qiptarëve-K, dhe vetëm 14% deklaruan se bashkëpunojnë në nivel të lartë me bizneset e shqiptarëve-K. Nga kompanitë që deklaruan se kanë nivel të lartë bashkëpunimi, 80% janë nga Jugu i Kosovës, ndërsa nuk ka dallime në mes të kompanive me madhësi të ndryshme. Niveli i ulët, në përgjithësi, i bashkëpunimit të bizneseve të serbëve-K në Veri me kompanitë në Jug është konfirmuar edhe në sondazhin e fundit të ICO-së në Veri të Kosovës². Kompanitë e serbëve-K e konsiderojnë rritjen **ekonomike në Kosovë** si faktorin kryesor që ndikon në bashkëpunimin në mes të komuniteteve të ndryshme në Kosovë, e përcjellë nga **potencialet për rritje të përfitimeve ekonomike përmes bashkëpunimit dhe themelimit të rrjeteve rajonale dhe qendrore të biznesit** në mes të komuniteteve të biznesit në Kosovë. Për bizneset e serbëve-K, **gjuha** u radhit si pengesa më e madhe për bashkëpunim, e përcjellë nga **siguria**, tregu i zi/krimi i organizuar, dhe **besimi**. Gatishmëria nga komunitetet tjera të biznesit dhe presioni nga shoqëria u radhitën në pozitën më të fundit me pikët më të ulëta. Këto rezultate tregojnë se ekziston gatishmëri në mesin e kompanive të serbëve-K për bashkëpunim, dhe se nuk ka ndonjë presion të madh nga shoqëria për të mos bashkëpunuar, siç mund të pritej. Është interesante të shihet se gjuha është pengesa më e madhe për bashkëpunim, kur e kemi parasysh se bizneset serbe nga Serbia dhe produktet e tyre janë të prezantuara në masë të madhe në tregun e Kosovës (më shumë se 300 milion euro në vit). Në përgjithësi pengesa kryesore sipas bizneseve të serbëve-K është korrupsioni. Korrupsioni pasohet nga shmangia fiskale dhe tregu i zi.

Përfundimet e raportit janë se intervenimet politike për ta shtyrë integrimin socio-ekonomik të komuniteteve etnike kane çuar drejt progresit shumë të ngadalshëm, sidomos në Veriun e Kosovës. Në të kundërtën, hulumtimi tregon mundësinë e nxitjes së integritimit duke ngritur bashkëpunimin në nivel biznesi. Ekziston gatishmëri

¹ Me Veri nënkuptojmë komunat në verë të lumit Ibër ndërsa me Jug pjesën tjetër të rajoneve të Kosovës.

² Më shumë se 65% e serbëve-K mendojnë se nuk ka nevojë për të pasur ndonjë kontakt komercial me Jugun.

nga të dyja palët për të bashkëpunuar nëse ka mundësi për përfitim dhe zhvillim ekonomik. Sidomos në agro-biznes, pylltari dhe turizëm ekziston potencial për bashkëpunim. Ndikimi i zhvillimit të madh ekonomik në bashkëpunimin e përmirësuar pritet të jetë më i madh se sa nga bashkëpunimi në zhvillim ekonomik. Andaj, masat për nxitjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik janë pjesë dominuese e rekomandimeve. Bashkëpunimi i biznesit është shtysë shumë e fuqishme drejt krijimit të urave në ndarjet e tanishme në mes të grupeve etnike në Kosovë. Sidoqoftë, ne e potencojmë se bashkëpunimi në biznes nuk mund të shihet si i izoluar dhe aspektet sociale si besimi dhe aspekti politik, si institucionet qeveritare të cilat duhet të jenë funksionale, luajnë rol të ngjashëm në mënyrë që të krijohen marrëdhënie biznesi që mundësojnë përfitime ekonomike në afat të gjatë.

Rekomandimet janë të ndara në rekomandime të politike, rekomandime për komunitetin e biznesit dhe rekomandime për donatorët ndërkombëtarë.

Rekomandimet për politika

- Zhvillimi i një strategjie të re integrimi që do ta vejë theksin në aktivitetet afat-mesme (3-5 vjet) drejt integrimit të komunitetit të biznesit të serbëve-K dhe që do ta reduktojë izolimin e tyre.
- Fuqizimi i mjedisit të biznesit dhe puna drejt zhvillimit ekonomik në nivel makro-ekonomik.
- Rritja e besimit të komunitetit të serbëve-K në institucionet qendrore dhe lokale.
- Sigurimi i pjesëmarrjes aktive të kompanive të pakicave në oferta për tenderë qeveritarë dhe sigurimi i vlerësimit të paanshëm të ofertave dhe dhënies së kontratave.
- Rritja e aktiviteteve për promovimin e bizneseve që i synojnë në mënyrë specifike bizneset e serbëve-K, duke i ndërlidhur ato me bizneset tjera në Kosovë përmes ngjarjeve të ndryshme, panairove dhe aktiviteteve të tjera promociionale.

- Qeveritë lokale të komunave të serbëve-K do të jenë të hapura dhe do t'i rrisin stimulimet për investimet e jashtme dhe kështu do ta përmirësojnë nivelin e përgjithshëm të bashkëpunimit.
- Trajtimi i bizneseve serbe nga Veriu në mënyrë të njëjtë si bizneset tjera në Kosovë nëse janë plotësisht të regjistruar në administratën e Kosovës.
- Tregtia, nëse të gjitha dokumentet janë në rregull, duhet të jetë e mundur dhe madje të inkurajohet në mes të Veriut dhe pjesës tjetër të Kosovës.
- Ofrimi i sigurisë dhe lirisë së lëvizjes për njerëzit e Veriut në tërë Kosovën.

Akterët e biznesit

Asociacionet e biznesit në Kosovë duhet të luajnë rol më aktiv drejt integrimit të bizneseve të serbëve-K nga Jugu dhe Veriu i Kosovës.

- Shoqatat duhet të organizojnë panairove të përbashkëta me fokus në promovimin e prodhimeve vendore, potencialeve dhe stimulimeve të tjera për bashkëpunim
- Agjencitë për investim duhet t'i promovojnë mundësitë e biznesit në rajonet e serbëve-K, me theks të veçantë në përparësitë krahasuese të këtyre rajoneve.

Donatorët ndërkombëtarë

- Përkrahja e qeverisë në zbatimin e rekomandimeve të politikave të përcaktuara më lart.
- Themelimi i programeve për përkrahjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe për zhvillimin e tregut, duke u fokusuar në sektorët me potencial të lartë për integrim.
- Puna drejt uljes së izolimit të komunitetit të bizneseve të serbëve-K. Nxitja e integritit në asociacione të biznesit, oda ekonomike, aktivitete promovimi tregtie dhe biznesi, etj.
- Fuqizimi i kapaciteteve të komunave për zhvillim ekonomik lokal dhe rajonal në pajtim me procesin e vazhdueshëm të decentralizimit me fokus në komunat e reja serbe.
- Në Veri, përkrahja e iniciativave që punojnë në drejtim të integritit, në nivel biznesi (fonde nismëtare, trajnime, lidhje me jugun), nivel të shoqërisë (pajtim dhe ndërtim i besimit) dhe nivel institucional (regjistrimi i biznesit, lëshimi i ID të Kosovës, etj.).
- Lansimi i kampanjës informative në mënyrë sa më të paanshme të mundshme për mundësitë e përparimit në Kosovë.
- Zhvillimi i strategjisë së përbashkët të intervenimit në Veri në mes të gjithë donatorëve prezent dhe koordinimi i intervenimeve të tyre përkatëse në mënyrë që të mos dyfishohen, apo edhe më keq, të punojnë kundër intervenimeve të donatorëve tjerë.

Për shkak të karakteristikave të Veriut, nevojitet të përcillen principet në vijim për secilin intervenim:

- Konteksti në Veri është i ndryshëm nga pjesa tjetër e vendit. Prandaj, thjesht për t'i zgjeruar programet nga Jugu në Veri bart një rrezik të trashëguar se intervenimet nuk do të funksionojnë apo madje edhe mund të dëmtojnë synimin e integritit. Për Veriun, të ndahet nevoja për analizën e kontekstit që duhet të bëhet dhe zgjidhjet dhe intervenimet të bazohen në to.
- Efektet e secilit intervenim nevojitet të monitorohen nga afër dhe në vazhdimësi. Intervenimet që përkrahin integritin duhet të fuqizohen; intervenimet që mund të jenë të dëmshme për procesin e integritit duhet të ndalohen shpejt apo të ndryshohen. Intervenimet mund të kthehen shumë shpejt nga një lloj në llojin tjetër. Një qasje e vazhdueshme "mos-shkakto-dëm" nevojitet të aplikohet si një minimum.
- Projektet nevojitet të bëjnë një vlerësim të kujdesshëm të rrezikut kur i zgjedhin partnerët lokal pasi që ka dëshmi narrative të njerëzve me ndikim në Veri që gjithnjë e më shumë po i fitojnë grantet e donatorëve dhe po i përdorin ato kryesisht për përfitim ekonomik të tyre vetanak. Donatorët duhet t'i shkëmbejnë përvojat e tyre me partnerët vendorë për ta përmirësuar shpërndarjen e drejtë të fondeve të donatorëve.
- Zbatimi i vazhdueshëm i nevojave të menaxhimit të projekteve të ndjeshme të konfliktit të sigurohet për të gjitha intervenimet në Veri.

Në raport janë specifikuar disa opsione për aktivitete konkrete.

Falënderim

Do të dëshironim ta falënderojmë Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë për përkrahje të këtij studimi. Falënderimet tona shkojnë për Prof. Muhamet Sadiku, i cili e përkrahi ekipin me të dhëna thelbësore për historinë që rezultoi deri në situatën momentale si edhe mënyra të mundshme për të shkuar përpara. Dëshirojmë t'i falënderojmë te gjithë ata që ishin të gatshëm për të marrë pjesë në intervista, qoftë si

informatore kyç apo si pjesë e hulumtimit. Në mënyrë të veçantë dëshirojmë ta përmendim Adrijana Hodžić – MPT, Besim Mustafa - KCC, Boban Simić –UNDP, Dejan Radivojević – UNDP, Gordana Đorić- Avenija, Viktor Popović - PER, Xhemajl Sylja - MTI-SMESA, për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në punëtori ku janë miratuar gjetjet dhe rekomandimet tona.

Përmbajtja

PJESA I	13
1.1	Hyrje..... 14
1.2	Analiza e kontekstit..... 15
1.2.1	Përshkrimi i problemit 15
1.2.2	Analiza ekonomike..... 15
1.2.3	Mjedisi i biznesit 16
1.2.4	Rregullat dhe rregulloret 17
1.2.5	Çështjet ndërlidhëse 18
1.3	Rezultatet dhe analiza e hulumtimit..... 21
1.4	Përfundimet 25
1.5	Rekomandimet 26
1.5.1	Rekomandimet për politika..... 26
1.5.2	Rekomandimet për akterët e biznesit..... 27
1.5.3	Rekomandimet për donatorët ndërkombëtarë 27
1.5.4	Opsionet për aktivitete konkrete 28
PJESA II	29
2.1	Metodologjia..... 30
2.1.1	Hulumtimi i materialeve të shkruara..... 30
2.1.2	Intervistat me informatorët kyç..... 30
2.1.3	Sondazhi 30
2.1.4	Analiza e studimit të rasteve 31
2.1.5	Analiza e sistemeve 31
2.2	Analiza e sistemeve 34
2.2.1	Karakterizimi i sistemit 34
2.2.2	Përcaktimi i modelit të sistemit 34
2.2.3	Analiza e ndjeshmërisë 36
2.2.4	Analiza e zbrazëtimeve 41
2.2.5	Zgjedhja e variablave për intervenim 43
2.2.6	Perspektivat 45
2.2.7	Modelet dhe intervenimet e mundshme 45
Referencat	48
Shtojcat	49

Shkurtesat

AMCHAM	Oda Ekonomike Amerikane (OEA)
BEEPS	EBRD-Hulumtimi i Bankës Botërore për Mjedis dhe Performancë të Ndërmarrjeve
AKRB	Agjencia e Kosovës për Regjistrimin e Biznesit
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
KQGj	Këshilli për Qeverisje Gjithpërfshirëse
GDP	Bruto Produkti Vendor
IBM	Korporata Ndërkombëtare për Makina Biznesi
ICG	Grupi Ndërkombëtar për Kriza
ICO	Zyra Ndërkombëtare Civile
FMN	Fondi Ndërkombëtar Monetar
Shqiptarët-K	Shqiptarë të Kosovës
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
KII	Intervistat Themelore Informative
Serbët-K	Serbët e Kosovës
EPK	Ekipi Përgatitor Komunal
MTI-SMESA	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – SME Agjencia Përkrahëse
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PRE	Projekti për Raportet Etnike
ADS	Analiza e Dinamikës së Sistemit
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
ZSK	Zyra e Statistikave të Kosovës
SWO-K	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë
ATK	Administrata Tatimore në Kosovë
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNMIK	Misioni i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PJESA I

1.1 Hyrje


Pjesëmarrja e komuniteteve të ndryshme etnike në të gjitha aspektet e jetës publike në Kosovë mbetet çështje thelbësore në lidhje me zhvillimin e institucioneve demokratike dhe promovimin e cilësisë në mesin e komuniteteve në Kosovë. Më e rëndësishmja është se ky është parakusht për një të ardhme pa tensione etnike dhe konflikt të dhunshëm. Përderisa ka pas progres të dukshëm në lidhje me përfaqësimin politik të komuniteteve etnike në Kosovë, mbetet ende shumë për t'u bërë në lidhje me pjesëmarrjen socio-ekonomike të komunitetit serb. Ky studim, në mesin e të tjerave, tregon se shkalla e pjesëmarrjes së komunitetit serb në jetën ekonomike në Kosovë është ende shumë e ulët. Ka mungesë të qasjes aktive për t'i zbutur brengat dhe problemet e komunitetit serb për të marrë pjesë në sistemin ekonomik të Kosovës në përgjithësi, dhe ka mungesë të promovimit të politikave përkrahëse për qasje të barabartë të të gjithë qytetarëve në shërbimet qeveritare dhe mundësitë ekonomike. Në lidhje me këtë, Instituti Riinvest dhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) kanë identifikuar nevojën për një studim në mënyrë që të analizohen pengesat, sfidat dhe opsionet për zhvillim të kësaj çështje shumë të ndjeshme, të identifikohen rrethanat aktuale të pjesëmarrjes së komunitetit serb në sistemin e tregut të Kosovës dhe të analizohet nëse ekonomia e Kosovës është diskriminuese ose jo dhe nëse e nxit pjesëmarrjen e mëtutjeshme të komunitetit serb në jetën socio-ekonomike. Studimi është financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes SCO-K dhe është zbatuar nga Instituti Riinvest dhe Avenjia, një OJQ serbe në Kosovë, me përkrahje metodologjike nga një konsulent ndërkombëtar.

Katër pyetjet kryesore në vijim janë definuar për t'u dhënë përgjigje nga studimi: (1) Cili është niveli i përfshirjes së komunitetit Serb në aktivitetet ekonomike të Kosovës? (2) Cilat janë barrierat dhe pengesat që e parandalojnë integrimin më aktiv të komunitetit të biznesit serb në ekonominë e Kosovës? (3) Cilat janë potencialet dhe mundësitë e biznesit për zhvillim të mëtutjeshëm? Dhe (4) Deri në çfarë niveli e ndihmon procesi i bashkëpunimit të biznesit, si shtytje e integritetit socio-ekonomik, komunitetin serb për t'i tejkaluar ndarjet në mes të grupeve etnike në Kosovë?

Studimi vlerëson një kontekst shumë të ndërlidhur dhe kompleks. Prandaj, u zgjodh Analiza e Dinamikës së Sistemeve (ADS) si metodologji që i mbulon të gjitha.

ADS e strukturon tërë procesin nga përshkrimi i procesit deri te mbledhja e të dhënave, analiza e të dhënave dhe zhvillimi i strategjisë. Në hapat e ndryshëm të ADS-së, njohuria për sistemin mbledhet në një mënyrë shumë gjithëpërfshirëse duke përdorë metoda të ndryshme, dhe duke kombinuar mjete kuantitative dhe kualitative të hulumtimit. Në Figurën 1 është dhënë një përshkrim i të gjitha hapave të ADS-së.

Figura 1: Hapat e Analizës së Dinamikës së Sistemeve



Burimi: Adaptuar nga Frischknecht dhe Schmied, 2009³

Hulumtimi i materialeve të shkruara, intervistat me informatorët kyç dhe një sondazh me 300 biznese në Kosovë (200 serbë-K, 100 shqiptarë-K) kontribui në mbledhjen e të dhënave për analizën e sistemit. Këto metoda si edhe kjo metodologji për analizën e sistemit janë përshkruar më detajisht në Pjesën II.

Raporti prezanton gjetjet e hulumtimit të materialeve të shkruara dhe intervistat me informatorët kyç, duke mbuluar përshkrimin e problemit, analizën ekonomike, analizën e rregullave dhe rregulloreve, dhe analizën e çështjeve ndërlidhëse në pjesën 1.2. Rezultatet e sondazhit të bizneseve janë të prezantuara ndaras në pjesën 1.3 të pasuara nga përfundimet dhe rekomandimet në pjesët 1.4 dhe 1.5, përkatësisht. Analiza e sistemit është e përshkruar në vijim në pjesën 2.2.

³ Frischknecht and B. Schmied (2009): Umgang mit Umweltsystemen. Methodik zum Bearbeiten von Umweltproblemen unter Berücksichtigung des Nachhaltigkeitsgedankens. Aktualisierte und überarbeitete Neuauflage. OekomVerlag, München.

1.2 Analiza e kontekstit

1.2.1 Përshkrimi i problemit

Pas një konflikti të gjatë ndër-etnik, komuniteti ndërkombëtar themeloi administratën ndërkombëtare në Kosovë në vitin 1999 duke e miratuar Rezolutën 1244 të KB-ve dhe duke vendosur Misionin e Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Qëllimi ishte të ndërprehet konflikti i dhunshëm dhe të krijohet paqja në Kosovë. Përkundër këtij intervenimi ndërkombëtar, Kosova është sfiduar vazhdimisht nga trashëgimia e konfliktit etnik dhe mungesa e një qasje realiste nga të gjitha komunitetet. Qëndrimi i komunitetit serb ndaj situatës së re të krijuar është penguar nën ndikimin e Beogradit dhe asaj që ndodhi në vitet e 1990-ta. Gjatë asaj kohe, regjimi e ka keqpërdorur komunitetin serb në Kosovë për t'i dëmtuar komunitetet tjera, sidomos komunitetin shqiptar në Kosovë.

Autoritetet serbe në Beograd, por edhe komuniteti serb në Kosovë, e kanë konsideruar intervenimin ndërkombëtar në Kosovë si okupim të "territorit të Serbisë". Që nga fillimi i administratës ndërkombëtare, komuniteti serb e pa situatën në kontekst të sigurisë për jetë dhe lirisë së lëvizjes, përderisa shqiptarët dhe komunitetet tjera jo-serbe e perceptuan situatën e re si mundësi për të filluar një periudhë të re politike, ekonomike dhe kombëtare. Procesi i pajtimit u dëmtua edhe më tej nga situata e re e krijuar në Kosovën veriore, që konsiderohet burim i jostabilitetit institucional nga komuniteti shqiptar, ndërsa komuniteti serb e konsideron si fortifikatë të rezistencës ndaj procesit të ndërtimit të shtetit në Kosovë.

Pasi që Rezoluta 1244 e KB-ve nuk i është referuar në mënyrë të qartë statusit final politik të Kosovës, komuniteti serb në jug të Kosovës u pajtua të merr pjesë në zgjedhjet lokale dhe kombëtare në Kosovë, duke i marrë ulëset e tyre në Parlamentin e Kosovës dhe kuvendet e disa komunave, por edhe disa pozita udhëheqëse në qeverinë qendrore të Kosovës. Edhe pse kjo pjesëmarrje është sfiduar nga ndikimi i fortë i Beogradit, duke ndërtuar struktura "paralele" serbe në Kosovë, dhe gjithashtu me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, mund të shihet si rezultat sinjifikant sa i përket përfaqësimit politik të pakicës serbe. Megjithatë mbetet edhe shumë për t'u bërë në mënyrë që të sigurohet përkrahje për pjesëmarrjen e

tij socio-ekonomike. Sondazhet e mëparshme të bëra nga Instituti Riinvest tregojnë se shkalla e pjesëmarrjes në jetën ekonomike të komunitetit serb mbetet shumë e ulët. Në lidhje me këtë, ekziston nevoja për hulumtim për t'i identifikuar pengesat, mundësitë dhe kanalet për zhvillim në këtë fushë të ndjeshme, duke i definuar rrethanat aktuale të pjesëmarrjes së komunitetit serb në tregun e Kosovës dhe duke përcaktuar nëse tregu nuk është diskriminues dhe e stimulon pjesëmarrjen e mëtutjeshme të komunitetit serb në jetën ekonomike dhe sociale. Gjithashtu ekziston nevoja për udhëzime konkrete në nivel të politikave por edhe në nivel të akterëve të biznesit si edhe të komunitetit ndërkombëtar për ta nxitur integrimin ekonomik të komunitetit serb në Kosovë.

1.2.2 Analiza ekonomike

Kosova është një nga shtetet më të varfra në Evropë, me varfëri ekstreme që dominon në 12% të popullsisë që jeton me €1.02 për ditë, përderisa 34% të popullatës jetojnë nën kufirin e varfërisë me €1.55 për ditë (UNDP, 2012). Papunësia është një nga sfidat kryesore në ekonominë e vendit dhe ndikon te 40% deri 45% të popullsisë (ZSK, 2009). Kurse në anën tjetër, shkalla e punësimit për të rinjtë e të gjitha etnive në Kosovë është 28%. Komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptas (RAE) është më i pafavorizuari, me shkallë të punësimit prej 17%, Serbët-K me 23%, Shqiptarët-K me 29% (Corbanese dhe Rosas, 2007).

Rritja e GDP-së në Kosovë nuk është e qëndrueshme në afat të gjatë pasi që kryesisht drejtohet nga konsumi qeveritar, shpenzimet publike, dërgesat dhe ndihma nga jashtë. Kosova vazhdon të ketë GDP-në prej 4.7 miliardë euro (IMF, 2011). Rritja e vërtetë e GDP-së ka zbritur nga 5.4% në vitin 2008 deri në 4.6% në vitin 2010 dhe 5% në vitin 2010 (Raporti i Progresit të KE-së, 2010; Raportit të Progresit të hartuar në Kosovë, 2011). Që nga viti 2002 e deri në vitin 2007, Kosova shpesh herë përjetoi teprica të buxhetit të cilat e arritën kulmin në vitin 2007 me rreth 2% të tepcës së buxhetit si përqindje e GDP. Megjithatë, pas vitit 2007 vendi përjetoi vazhdimisht deficit të buxhetit duke e arritur pikën më të ulët në vitin 2011 me rreth 1.5% të GDP (FMN, 2011).

Kosova vuan nga deficitet momental i llogarisë në balancimin e pagesave kryesisht për shkak të balanit negativ

Rasti studimor 1

Klllokoti është rajon i njohur për burimet e tij të ujit mineral. Një nga këto burime, i pasur me minerale, është gjetur në oborin e një pronari. Pronari e ka filluar biznesin e tij për prodhimin e ujit mineral në vitin 2002 dhe momentalisht ka të punësuar 12 persona. Kompania e tij është kompania e vetme e prodhimit industrial e serbëve-K por jo e vetmja kompani për prodhimin e ujit. Ekzistojnë dy biznese të shqiptarëve-K në të njëjtin rajon që prodhojnë ujë mineral dhe me njërën nga këto ka bashkëpunim shumë të mirë dhe i shkëmbejnë materialet furnizuese kur është e nevojshme.

Sot, kompania vepron me vetëm 30% të kapacitetit të saj për shkak të vështirësive në qasjen e tregjeve jashtë rajonit. Momentalisht, ata u shesin 30% të rajoneve të banuara me shqiptarë-K dhe 70% të rajoneve të banuara me komunitet të serbëve-K. Kompani e ka të vështirë të eksportojë ujë për shkak të pengesave administrative edhe pse pronari ka disa kontakte në rrethinë të Kosovës. Pronari nuk mendon se arsyeja kryesore që nuk është në gjendje të shes jashtë tregut lokal është për shkak se është serb. Ai mendon se ekzistojnë çështje sistematike në kuadër të tregut, i cili ende nuk është i organizuar mirë. Ai bashkëpunonte me kompani në Veri të Kosovës por ky bashkëpunim u zhduk pasi që kompanitë në Veri kanë kushte më të mira sa i përket lidhjeve dhe zgjedhje më të gjerë të prodhimit nga tregu i Serbisë.

të tregtisë, me import dukshëm më dominuese sesa eksporti. Në shtator 2010, deficitin momental i llogarisë shkon deri në 16.9% të GDP (BQK, 2010).

Sektori privat në Kosovë është duke nen-performuar dhe duke dështuar vazhdimisht në arritjen e potencialit të vet. Nga 105,000 kompani të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Biznesit (BRAK), rreth gjysma nuk janë aktive sipas Administratës Tatimore të Kosovës (UNDP, 2012). Për më tepër, prodhimi vendor i Kosovës vazhdon të jetë i ulët. Nga të gjitha NVM-të e regjistruara 50% veprojnë në sektorin e tregtisë (Agjencia NVM, 2011).

1.2.3 Mjedisi i biznesit

Gjatë disa viteve të kaluara, qeveria e Kosovës ka arritur zhvillim në *mjedisin e biznesit*. Këto zhvillime përfshijnë reformat në krijimin e bizneseve të reja, legjislacionin e tregut të punës, rregulloret tatimore dhe ligjet konkurruese (UNDP, 2012). Megjithatë, këto reforma ende janë të pamjaftueshme për rritjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të punës.

Në vitin 2011, Instituti Riinvest ka bërë një studim me 600 biznese (publikuar nga UNDP, 2012). Nga bizneset e Kosovës u kërkuar t'i rangojnë 22 kategori të pengesave siç janë klasifikuar në sondazhin e BEEPS⁴.

Kategoritë 'konkurrenca e padrejtë' dhe 'praktikat anti-konkurruese të konkurrentëve tjerë' tregojnë intensitet më të lartë, të pasuara nga energjia elektrike, korrupsioni, shkeljet e kontratave, stabiliteti politik dhe shpenzimet dhe qasja në financa.

Raporti i Bankës Botërore "*Zhvillimi i Biznesit 2011*" e rangon Kosovën në vendin e 119-të nga 183 ekonomi në lidhje me lehtësinë e zhvillimit të biznesit. Nisja e biznesit dhe marrja me leje ndërtimi është e mundimshme siç është përcaktuar edhe nga raporti. Kosova rangohet shumë dobët në krahasim me shtetet fqinje siç është Maqedonia. Në lidhje me zbatimin e kontratës, Kosova rangohet gjithashtu shumë ulët, në vendin e 155-të. Tregtia përtej kufijve ishte gjithashtu një kategori ku Kosova u rangua dobët, në vendin e 130-të (Banka Botërore, 2011). Konfliktet e fundit të tregtisë në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe masat përkatëse të reciprocitetit mund t'i pengojnë më tej nivelet momentale të bashkëpunimit në mes të shqiptarëve-K dhe serbëve-K.

Një sondazh që është bërë me kërkesë të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë thekson se bizneset e serbëve-K besojnë se institucionet më problematike që e pengojnë zhvillimin e biznesit janë Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) dhe qeveritë lokale. Sipas këtij raporti, bizneset e serbëve-K, paraqesin një nivel relativisht më të ulët të pakënaqësisë me institucionet e Kosovës për shkak të mungesës së prezencës së institucioneve të Kosovës në ato hapësira (K. Shaipi, 2008).

Shmangia e tatimit e nxit konkurrencën e padrejtë, duke siguruar përparësi për bizneset të cilat i shmangen tatimin. Të dhënat tregojnë se niveli i shmangies së tatimit në Kosovë është rreth 39 %. Deri më tash, nga 65,000 biznese të regjistruara me numër fiskal, vetëm 13,000 biznese janë pajisur me makina të regjistruara të parave në dorë, qëllimi i të cilave është të reduktohet niveli i shmangies së tatimit në Kosovë (UNDP, 2012).

Sipas Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), bizneset e regjistruara janë të përbëra nga 96% mikro ndërmarrje, 2.3% ndërmarrje të vogla, 0.9% ndërmarrje të mesme, dhe 0.8% ndërmarrje të mëdha.

Gjatë intervistave me informatorët kyç kemi marrë informacione se shumica e bizneseve të serbëve-K janë ndërmarrje të vogla dhe biznese familjare, me numër të vogël të punëtorëve. Ata kanë mungesë të shkathëtisë menaxhuese dhe teknike dhe kanë produktiv-

⁴ EBRD-Hulumtimi i Bankës Botërore për Mjedisin e Biznesit dhe Performancën e Ndërmarrjeve (BEEPS)

itet shumë të ulët. Sidoqoftë, ata mund të veprojnë si furnizues i rëndësishëm kryesisht në sektorin e agrikulturës që përbën mbi 25% të GDP së Kosovës (UNDP, 2012).

Roli i bizneseve të serbëve-K në ekonominë e Kosovës konsiderohet i ulët për shkak të nivelit të tyre të ulët të pjesëmarrjes në treg. Niveli i pjesëmarrjes së bizneseve të serbëve-K në Jug është më i lartë se në Veri⁵. Një bashkëpunim shumë i suksesshëm joformal konsiderohet të jetë një rrjet i themeluar shqiptaro-serb që kontrabandon me të mira materiale pa tatim nga Serbia përmes Veriut në Kosovën jugore (ICG, 2011).

Shkëmbimi i informatave të biznesit në mes të dy komuniteteve mbetet shumë i ulët për shkak të mungesës së pjesëmarrjes së bizneseve të serbëve-K në panairë biznesi dhe ngjarje të organizuara nga komuniteti i bizneseve të shqiptarëve-K dhe e kundërta. Në anën tjetër, përkrahja e siguruar nga organizatat ndërkombëtare e ka përmirësuar rrjetin televiziv në gjuhën serbe që mbulon rreth 80% të popullatës serbe-K duke lejuar promovimin e produkteve të tyre brenda komunitetit serb-K në të gjitha rajonet e Kosovës (Raporti i Progresit të KE, 2011). Rrejt i radios së Asociacionit të Mediave të Kosovës gjithashtu transmeton në gjithë Kosovën në gjuhën serbe.

Një zhvillim i shtuar i sektorit privat në Kosovë është i domosdoshëm për nivelet e larta të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të punës (UNDP, 2012). Në mënyrë që të kemi zhvillim ekonomik në tërë rajonet e Kosovës, një mjedis më i mirë i biznesit është thelbësor. Pjesë e këtij mjedisi të reformuar të biznesit përfshin gjithashtu themelimin e bashkëpunimit në mes të bizneseve të shqiptarëve-K dhe serbëve-K.

1.2.4 Rregullat dhe rregulloret

Politikat Fiskale – Qeveria e Kosovës ndërmori disa masa të rëndësishme për ta përmirësuar mjedisin e biznesit, duke krijuar politika të favorshme fiskale në vitin 2009. Hulumtimet e mëparshme nga Instituti Riinvest treguan se pas zbatimit të ndryshimeve në politikat fiskale, tatimet kanë zënë një shkallë më të ulët në listën e vështirësive gjatë zhvillimit të biznesit, duke bërë të ditur se këto ndryshime kanë qenë pozitive.

5 Me Veri nënkuptojmë komunat e Leposaviqit, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Mitrovicës në verë të Lumit Ibër

Rasti studimor 2

Kompania është themeluar në një rajon shumë të njohur për prodhimin e patateve kështu që angazhohet kryesisht në prodhimin dhe procesimin e patateve, shitjen e filizave dhe makinerisë së patateve. Kompania kultivon 130 hektarë të tokës së vet dhe ka subkontraktuar 130 hektarë nga një fermer tjetër nga të cilat 10% janë të fermerëve serb-K në Veri. Momentalisht është duke eksportuar në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi dhe Kroaci. Ajo eksportonte produktet e veta në Ruman gjë e cila u ndërpre pasi që Rumania hyri në BE. Sot kompania mundohet të rivendos kanale pasi që e ka ngritur cilësinë siç kërkohet me standardet e BE-së. Para pavarësisë, ajo eksportonte edhe në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë, që në atë kohë mbulonte 30% të biznesit të saj. Tash, restriksionet e imponuara nga Serbia nuk lejojnë transportimin e prodhimeve me targa të Kosovës. Pronari mendon se nuk ka dallim etnie në zhvillimin e biznesit dhe do të dëshiron të zgjerojë prodhimin e farave në Veri për shkak të klimës së favorshme si edhe zgjerimin e tregut.

Politikat e Tregut – Kosova ka një politikë për tregti të hapur dhe në vitin 2006 e ka nënshkruar marrëveshjen CEFTA me synim të hapjes së kufijve të vet ndaj shteteve fqinje dhe anasjelltas. Megjithatë, liberalizimi i tregtisë nuk e ka ngritur konkurrencën në treg, duke e lënë kështu Kosovën me një deficit të jashtëzakonshëm tregtar (€1.85 bilion) (CBK, 2010). Marrëveshja CEFTA nuk u zbatua plotësisht për shkak të bllokadave të tregtisë të imponuara nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina për produktet nga Kosova. Mosmarrëveshjet e tilla e pengojnë vazhdimisht dhe vazhdojnë të jenë sfida kryesore për zhvillimin e biznesit të Kosovës.

Të drejtat mbi pronën – edhe pse janë bërë ndryshimet në kornizën ligjore në lidhje me të drejtat mbi pronën (ligji mbi kadastrat, amendamentet në ligjin mbi pronën e patundshme, ligji i tatimeve mbi pronën e patundshme, amendamentet në ligjin mbi shpronësimin), zbatimi ka qenë i vështirë dhe është arritur një nivel i përzier i progresit (Raporti i Progresit të KE, 2011). Në Mitrovicë, zbatimi i urdhrave të depërtimit dhe administratës së pronës kanë qenë sfida, andaj edhe mosmarrëveshjet ndëretnike janë tejzgatur në gjykatat lokale (Raporti i Progresit, 2011). Mosmarrëveshjet mbi të drejtat në pronë dhe situatat e paqarta të pronësisë janë duke e penguar mjedisin e biznesit dhe duke i kufizuar mundësitë e investimeve.

Sistemi gjyqësor në Kosovë mbetet shumë i dobët. Brenda sistemit gjyqësor ende ekziston një grumbull i rasteve të pazgjidhura, ka korrupsion dhe nepotizëm (Raporti i Progresit, 2011). Zbrazëtia në sistemin legjislativ mundëson praktika të korruptuara biznesi. Duke vazhduar me këtë çështje, ende ka raporte të shumta të kërcënimeve dhe kanosjeve ndaj gjykatësve, sidomos në lidhje me rastet e ndjeshme si të drejtat

Rasti studimor 3

Malet e Sharit janë varg i maleve në jug-perëndim të Kosovës të cilat kanë pothuaj se 2,000 lloje bimësh, duke përfshirë boronica, manaferra, qershia dhe dredhëza. Momentalisht, vetëm në komunën e Shtërpces manaferrat kultivohen në rreth 22 hektarë. Prodhimi i manaferrave është dëshmuar të jetë një nga aktivitetet më të përshtatshme ekonomike që mund të sigurojnë të hyra për familjet në këtë hapësirë. Biznesi i prodhimit të frutave të malit ka funksionuar shumë mirë gjatë disa viteve të fundit në komunën e Shtërpces, duke përfaqësuar një biznes në të cilin serbët dhe shqiptarët janë të përfshirë në mënyrë të barabartë. Asociacioni i prodhimit të frutave të malit është asociacion i regjistruar me 45 anëtarë prej të cilëve 11 anëtarë janë shqiptarë-K, 2 anëtarë janë boshnjakë-K dhe 32 janë serbë-K.

Prodhuesit, pavarësisht etnisë, kanë mundësi t'i mbajnë frutat e tyre në një depo të ftohtë e cila shërben edhe si pikë mbledhëse për manaferra dhe është pronë e një serbi-K. Momentalisht 90% e prodhimit të tij shiten në Serbi ndërsa shitja e mallit të ngrirë jashtë vendit në bashkëpunim me bizneset e shqiptarëve-K ka stagnuar për shkak të ndryshimeve në treg në nivel global.

Biznesi i manaferrave është shumë i ri për pronarin dhe ai nuk ishte në gjendje të themelojë kanale me supermarketet kryesore në Kosovë pasi që nuk ishte në gjendje të sigurojë paketimin e përshtatshëm për produkt. Që nga ky vit ai do të investojë në dizajn të paketimit dhe marketing, i cili do të lejojë tregtinë me supermarkete. Me përkrahje teknologjike, si shpërndarje dhe prezantim i llojeve të reja, prodhimi i këtij rajoni do të mund të fuqizohet dhe të rritet.

Rasti studimor 4

Mogilla është një qytet në Komunën e Klllokotit i cili është rajon i mirë me tokë bujqësore ku komunitetet e të dy etnive, shqiptarë dhe serbë, jetojnë dhe punojnë së bashku. Në Klllokot, popullata e komunës përbëhet prej 72% serbë, 27% shqiptarë dhe 2% rom.

Asociacioni i Farmerëve të Mogillës të etnive të ndryshme ka pranuar disa fonde nga programet zhvillimore për të rritur në mënyrë të dukshme prodhimin bujqësor. Një nga përfituesit ishte një kompani individuale e cila i kultivon 12 hektarë të tokës së vet dhe tash shërben gjithashtu si pikë grumbulluese për produktet e të gjithë fermerëve pavarësisht etnisë. Produktet kryesore janë specat, domatet, patatet, lakra dhe qepët. Pika grumbulluese, e pajisur me depo ftohëse, parandalon prishjen e perimeve. Pronari ka investuar gjithashtu në serrë për fermerët e tjerë që do ta zgjerojë periudhën e prodhimit. Ai është duke planifikuar para-financimin e fermerëve me filiza dhe do të sigurojë garanci pagese për produkte.

Tregu kryesor i kompanisë është Kosova por ajo edhe i eksporton produktet në Shqipëri dhe vitin e kaluar ka eksportuar edhe në Serbi. Fermerët serbë-K i kanë shitur më herët prodhimet kryesisht në tregun e hapur në rajonin e Klllokotit dhe Gjilanit por tash mund t'i shesin produktet e tyre edhe në rajone tjera të Kosovës të cilat janë kryesisht të banuara me shqiptarë-K.

mbi pronën. Për më tepër, ligji vazhdon të jetë brengë për Kosovën veriore pasi që gjykata e Mitrovicës ende përbëhet vetëm nga gjykatës dhe prokurorë të EULEX-it dhe vepron me kapacitet të kufizuar (Raporti i Progresit, 2011). Strukturat paralele serbe të rrënjësura në Veri të Kosovës janë shumë dominuese andaj edhe integrimi i komunave në Kosovë është një sfidë e madhe (Raporti i Progresit, 2011).

Edhe pse këto probleme vazhdojnë dhe kanë ndikim në tërë popullatën e Kosovës, komuniteti i serbëve-K ka shumë të *drejta të garantuara* me ligj. Përfaqësuesit

politik serb i kanë të rezervuara 20 ulëse në organin kryesor legjislativ të Kosovës nga gjithsej 120 ulëse. I njëjti ligj vlen për pjesëmarrje në fuqi ekzekutive dhe emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve (Djukanovic, 2008). Megjithatë, edhe zbatimi i këtyre ligjeve mbetet në nivel të pakënaqshëm. Përveç kësaj, funksionimi i institucioneve të Kosovës ende nuk është i bazuar në principet e qeverisjes së mirë. Vendimet shpesh herë merren duke u bazuar në lidhje. Në këtë rast, komuniteti vetanak gjithnjë preferohet dhe etnitë tjera që nuk janë të integruara mjaftueshëm do të mbesin gjithnjë të diskriminuara (KII, 2011).

Megjithatë, shumë serbë-K ende i shfrytëzojnë institucionet paralele, sidomos në Veri të Mitrovicës. Ata mund të marrin dokumente, sigurim shëndetësor, arsimim, paga dhe shumicën e të mirave dhe shërbimeve në vend apo nga Serbia (ICG, 2011). Disa serbë-K e shprehën rolin e rëndësishëm që kanë institucionet paralele serbe në komunitetet e serbëve-K dhe se janë të frikësuar se nëse përkrahja nga Serbia ndërpritet situata e tyre do të përkeqësohet. Ata ende i shohin institucionet paralele si më të mira sa i përket cilësisë, sidomos në lidhje me arsimin dhe kujdesin shëndetësor dhe nuk besojnë se institucionet e Kosovës mund ta mbushin këtë zbrazëti.

Mjedisi ofrues për biznes është ende i penguar nga paaftësia për t'i zbatuar rregullat dhe rregulloret në mënyrë të drejtë në tërë territorin e Kosovës. Në mënyrë që të ngritet niveli i bashkëpunimit, besimit ndër-etnik, infrastrukturës vendore të biznesit, rregullat dhe rregulloret duhet të zbatohen drejt në tërë territorin e Kosovës.

1.2.5 Çështjet ndërlidhëse

Ekziston mungesë e hulumtimit dhe informacionit në lidhje me nivelin momental të bizneseve që janë pronë e grave, si edhe në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në pozita menaxhuese, punësim, paga dhe pjesëmarrje në vendim-marrje politike dhe sociale. Asnjë informacion nuk mund të mblidhet në lidhje me dallimet e përfshirjes së bizneseve në mes të grave shqiptare-K dhe serbe-K.

Sipas hulumtimit të bërë nga Ann Androsik (2007), numri i bizneseve të regjistruara në Mitrovicën Veriore deri në shtator 2002 ishte 375. Nga këto biznese, 33% ishin pronë e grave. Ky hulumtim vuri në pah se gratë të cilat kryesisht punojnë për kompani të cilat e ndërprejnë veprimtarinë pas luftës filluan të hapin biznese

të vogla tregtare private, përderisa të tjerat vendosën të qëndrojnë në shtëpi. Pas kësaj, nuk u bë asnjë studim në lidhje me gratë serbe-K në biznes në Veri apo rajone tjera.

Ndryshimet e fundit në ligjin e punësimit kanë përfshirë përfitime të ndryshme për gratë e punësuar, por që ne disa raste janë kthyer edhe si goditje. Sot, çmimi për t'i punësuar gratë është shumë i lartë për shkak të pushimit të gjatë të lehonisë, gjë që i diskurajon kompanitë për të punësuar gra, dhe rrjedhimisht mund të konsiderohet diskriminues. Sipas ligjit (Ligji Nr. 03/L-21), gratë kanë të drejtë deri në 12 muaj pushim lehonie kur pagat për 6 muajt e parë kompensohen 70% nga punëdhënësi.

Të dhënat tregojnë se në Kosovë gratë janë më të prirura të jenë të papuna në krahasim me meshkujt. Raporti i UNDP-së 2012 tregon se niveli i papunësisë së grave është 57% përderisa niveli i papunësisë së meshkujve qëndron në 41%. Përveç kësaj, shkalla e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës është 29% në krahasim me 67% të meshkujve.

Ekzistenca e strukturave paralele ka ndikim të konsiderueshëm në shoqërinë e Kosovës. Megjithatë, pas pavarësisë së Kosovës, serbët-K i kanë zgjedhur qeveritë lokale në komunat e banuara me shumicë të serbëve-K në Jug, të cilat u organizuan nga institucionet legjitime të Kosovës. Kjo ka çuar drejt dobësimit të ndikimit të strukturave paralele, të cilat sipas OSBE-së (2007) veprojnë nën autoritetin *de facto* të Qeverisë së Serbisë.

Sipas ICG (Grupit Ndërkombëtar të Krizave, 2011) situata në veri është e ndryshme. Referimi i Qeverisë së Kosovës ndaj komunave veriore si autoritete "paralele" është çorientues për shkak të faktit se komunat serbe janë të vetmet autoritete. Megjithatë, edhe pse administrata e UNMIK-ut nuk vepron më në tërë Kosovën, Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë (UAM) funksionon ende dhe përkon me administratën komunale serbe (ICG, 2011).

Kur u pyetën njerëzit që jetojnë në Veri të Mitrovicës se kush është në krye, përgjigjet e dhëna ishin shume të llojllojshme, në bazë të hulumtimit të nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet (KSI). Rreth 22% besojnë se Qeveria e Serbisë është në krye, 19% konsiderojnë se politikanët vendorë janë në krye, 19% besojnë se krimi i organizuar ndikon në qeverisjen e komunave ku jetojnë ata, 12% konsiderojnë se UNMIK-u është kompetent, 8% besojnë se komuniteti ndërkombëtar

Rasti studimor 5

Kompania profesionale për pastrim dhe mirëmbajtje, e bazuar në Graçanicë është biznes i krijuar nga partneriteti në mes të pronarëve serb-K dhe shqiptar-K. Ajo merret me pastrim dhe mirëmbajtje profesionale të të gjitha aspekteve të ndërtesave komerciale dhe banuese si pastrimi i tapicerive, tepihëve, pjesës së brendshme të veturave, fasadave, pllakave, mermerit në mes tjerash. Ajo ofron shërbime kryesish nga tenderët dhe kur kërkohet nga blerësit. Shitjet janë të shpërndara në tërë tregun e Kosovës dhe blerësit kryesor të kompanisë janë nga komuniteti i serbëve-K dhe shqiptarëve-K në sasinë e njëjtë. Përveç kësaj, trendi i së ardhmes për shitje sa i përket komunitetit të shqiptarëve-K mendohet se do të rritet për 10 përqind siç pritet edhe nga komuniteti serb-K. Në përgjithësi i tërë tregu i Kosovës konsiderohet treg potencial për të ardhmen e biznesit. Firma është plotësisht e furnizuar nga kompanitë që janë pronë e shqiptarëve-K me lëndë të parë dhe produkte, kryesisht të vendosura në Prishtinë. Ky trend i furnizimit gjykohet pozitiv për të ardhmen gjithashtu. Kompania ka konsumatorë nga struktura të ndryshme etnike, si shqiptarë-K, serbë-K dhe rom, që nënkupton se asnjë etni nuk është e nënpërfaqësuar në veçanti kur bëhet fjalë për shërbime. Nuk ka patur asnjë lloj problemesh apo pengesash në zhvillimin e biznesit me shqiptarë-K dhe bashkëpunimi është në nivel normal. Vetë klientët nuk janë paragjyqes për faktin se kompania është bashkëpronë dhe punon me shqiptarë-K pasi që përfundimi i detyrave në mënyrë profesionale është ajo që ka rëndësi.

është ai që i ka kompetencat, dhe 21% nuk ishin të vetëdijshëm se kush është në të vërtetë në krye për qeverisjen e komunave të tyre. Ky konfuzion është shkaktuar nga numri i madh i palëve me interes të përfshira të cilët pretendojnë përgjegjësi pa veprime reale (KSI, 2009)

Grupi Ndërkombëtar i Krizave thekson se edhe përkundër faktit se pjesëmarrja e serbëve-K në jetën politike të Kosovës dukej e pamundur, zgjedhjet lokale të nëntorit 2009 dhe zgjedhjet kombëtare në dhjetor 2010 treguan të kundërtën. Serbët-K që jetojnë në jug votuan në numër të madh. Megjithatë, pengesë është se reagimi i njëjtë nuk mund të pritët nga serbët-K që jetojnë në Veri. Serbët-K që jetojnë në rajonet tjera të Kosovës votuan pasi që pjesët nën autoritetin shtetëror të Kosovës i rrethojnë, dhe kishin shumë pak alternativa. Shkalla e paraqitjes në zgjedhjet e vitit 2009 për tërë Kosovën ishte 45% përderisa në tre komuna të banuara nga shumica serbe-K ishte nga 23-27% në Ranillug 12%, përderisa në Veri pjesëmarrja ishte minimale (KFOS, 2010).

Mungesa e komunikimit në mes të partive politike dhe perceptimi se Serbia vendos rreth çdo gjëje i ka kontribuar ndjenjës së pafuqisë në mesin e popullatës së serbëve-K dhe i ka diskurajuar iniciativat serioze (KQGj, 2010). Situata momentale politike dhe debatet në lidhje me ndarjen territoriale, apo statusi i veçantë për Veriun i bënë iniciativat gjithëpërfshirëse jo vetëm më pak tërheqëse për komunitetin e serbëve-K por gjithashtu më të vështira për zbatim.

Përveç kësaj, Serbia shpenzon rreth €200 milion në Veri të Kosovës, që ndihmon në mbajtjen e ndikimit. Ky është një faktor i fuqishëm që e pengon integrimin e serbëve-K. Për shkak të investimeve nga Serbia, të cilat shkojnë kryesisht në Veri, ai rajon është urban dhe plot gjallëri, salla të sportit dhe kampus universitar të një rangu me ato në Beograd. Spitali në Veri të Kosovës është i madh dhe me personel të mirë, ku shumë qytetarë nga e tërë Kosova që i marrin shërbimet mjekësore aty (ICG, 2010).

Të dhënat e paraqitura përmes hulumtimit sekondar ofrojnë informata në lidhje me *qeverisjen lokale* dhe si ka ndikuar ky proces në jetë në përgjithësi, por nuk ofron informata se si ka ndikuar në biznes. Krijimi i komunave të reja ka ndikuar në mënyrë indirekte në biznese. Komunitetet e reja janë foshnje të donatorëve dhe kanë pranuar fonde të ndryshme, pjesë e të cilave përfundojnë në biznese (KII 2011). Përveç kësaj, shumë persona janë përgjigjur gjatë intervistave se strukturat paralele mund të kenë ndikim më të madh në Veri të Kosovës se sa në pjesët tjera të banuara nga serbët-K.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (2008) ka bërë një studim duke u munduar të shpjegojë ndikimin e *korruptionit* në biznese. Nga të intervistuarit, 40%

e bizneseve të shqiptarëve-K dhe 18% e bizneseve të serbëve-K theksuan se janë ballafaquar me korruptionin në raste të ndryshme. Serbët-K e theksuan se kryesisht kanë përjetuar korruption në nivel lokal përderisa një pjesë e ndjeshme e shqiptarëve-K kanë theksuar se ka nivel të lartë të korruptionit në nivel qendror.

Raporti i Progresit të KE (2011) në Kosovë thekson se është bërë progres i kufizuar në lidhje me promovimin dhe zbatimin e *të drejtave të njeriut*, përkundër faktit se Kosova vazhdon ta zbatojë strategjinë dhe planin e veprimit për të drejtat e njeriut. Raporti i njëjtë thekson se mekanizmat e të drejtave të njeriut nuk janë të koordinuara në mënyrë efikase edhe në nivel qendror edhe në nivel komunal (KE, Raporti i Progresit, 2011). Në lidhje me mbrojtjen e pakicave, raporti i progresit thekson se ka pas progres të kufizuar, por se procesi i decentralizimit ofron kornizë të mirë për përmirësim në të ardhmen. Sipas OSBE-së, mungesa e një sistemi plotësisht funksional të drejtësisë në Mitrovicë ka çuar drejt shkeljes së të drejtave të njeriut si e drejta për qasje në drejtësi dhe e drejta për gjykim brenda një periudhe të arsyeshme kohore (OSBE, 2011).


1.3 Rezultatet dhe analiza e hulumtimit

Siç e kemi sqaruar në pjesën e metodologjisë së hulumtimit, ekipi i ka intervistuar 300 biznese në tërë Kosovën, në mënyrë specifike 200 biznese të serbëve-K dhe 100 të shqiptarëve-K. Qëllimi i hulumtimit ka qenë që të merret një pasqyrë më e qartë për nivelin e përfshirjes së komunitetit të bizneseve serbe në aktivitetet ekonomike të Kosovës. Qëllimi ishte të jepen përgjigje në pyetjet në vijim. Cilat janë pengesat kryesore që e parandalojnë integrimin më aktiv të komunitetit serb në aktivitetet ekonomike? Cilat janë potencialet dhe mundësitë e biznesit për zhvillim të mëtutjeshëm? Dhe, deri në çfarë mase ndihmon procesi i bashkëpunimit të bizneseve në integrimin e tyre?

Siç edhe kane qene pritjet fillestare, shumica e bizneseve të serbëve-K janë të vogla. Nga të gjitha bizneset e serbëve-K që janë intervistuar, rreth 93% e tyre theksuan se janë biznese që janë ne pronësi individuale. Bizneset e serbëve-K janë kryesisht të angazhuara në dhënie të shërbimeve dhe në tregti (rreth 76% prej tyre), përderisa një pjesë më e vogël është e angazhuar në prodhim/procesim (24%). Këto rezultate janë në pajtim edhe me gjetjet nga burimet tjera, si hulumtimi i te dhënave sekondare dhe intervistat me palët me interes. Sipas palëve me interes, sektorët kryesorë të identifikuar në vendet e banuara nga serbët-K janë turizmi, agrobiznesi dhe pylltaria, dhe këto përfundime u përkrah gjithashtu edhe nga të dhënat e hulumtimit. Për më tepër, disa nga palët me interes mendojnë se bizneset e serbëve-K mund të veprojnë si ndërmjetësues për eksportin e prodhimeve të Kosovës në Serbi dhe shtetet tjera të rajonit, për shkak të gjuhës dhe marrëdhënieve kulturore.

Madhësia e bizneseve të serbëve-K është e shprehur (dhe mund të shihet qartë) gjithashtu edhe nga vizioni i tyre për të ardhmen. Rreth 70% të bizneseve të serbëve-K e shohin tregun e tyre lokal (vendlin ku ata jetojnë) si tregun e tyre potencial në të ardhmen. Rreth 20% e tyre e shohin tregun e Kosovës si tregun e tyre potencial, ndërsa vetëm 10% mendojnë për vendet e rajonit (eksport) si tregun e tyre potencial në të ardhmen. Bizneset e serbëve-K janë gjithashtu të vogla sa i përket qarkullimit të tyre vjetor. Rreth 27% e tyre kanë qarkullim deri në 5,000 euro në vit, përderisa 60% të tyre kanë qarkullim deri në 50,000 euro në vit. Pjesa tjetër e bizneseve janë me më shumë se 100,000 euro qarkullim në vit. Ne i shikuam edhe dallimet në qarkullim në mes të bizneseve të

Figura 2: Shkalla e qarkullimit të kompanive K-Serbe në Veri dhe Jug gjatë vitit 2010




Burimi: Sondazhi me bizneset K-Serbe

serbëve-K në Veri dhe Jug të Kosovës. Rezultatet tregojnë se 94% e bizneseve në Jug kishin qarkullim deri në 50,000 euro në vitin 2010. Në ndërkohë rreth 46% të bizneseve në Veri kanë qarkullim shumë të vogël. Një dallim shumë i madh është vërejtur edhe në qarkullimin mbi 100,000 euro. Një numër i konsiderueshëm i bizneseve të serbëve-K në Veri (52%) raportuan se kanë qarkullim të tillë, përderisa vetëm 5% të bizneseve të serbëve-K në Jug të Kosovës deklaruan qarkullim të tillë. Nga këto të dhëna mund të konkludojmë se bizneset e serbëve-K që veprojnë në Veri janë më të mëdha në krahasim me bizneset e serbëve-K që veprojnë në Jug të Kosovës. Kjo mund të jetë për shkak të qasjes në një treg më të madh në Veri të Kosovës dhe faktit se disa nga ato janë kompani të vjetra, të themeluara para vitit 1999 (për më shumë detaje shih figurën 2).


Ne i pyetëm bizneset për nivelin e tyre të bashkëpunimit me bizneset tjera, d.m.th. me bizneset e serbëve-K, bizneset e shqiptarëve-K dhe me bizneset tjera në Kosovë. Nga ta u kërkua ta rangojnë bashkëpunimin e tyre me bizneset nga etnitë tjera si nivel të lartë, të mesëm apo të ulët, në raport me shkallën e bashkëpunimit të biznesit të tyre të përgjithshëm. Sipas të dhënave nga sondazhi, rreth 86% të bizneseve të serbëve-K bashkëpunojnë në nivel të ulët apo të mesëm me bizneset e shqiptarëve-K. Nga bizneset që deklaruan bashkëpunim të nivelit të

Figura 3: Faktorët që e ngrisin bashkëpunimin në mes të komuniteteve sipas bizneseve Serbe-K dhe bizneseve Shqiptare-K



Burimi: Sondazhi me bizneset

Figura 4: Pengesat për bashkëpunim sipas bizneseve Serbe-K dhe bizneseve Shqiptare-K



Burimi: Sondazhi

lartë, 80% janë nga Jugu i Kosovës, ndërsa nuk ka dallim në mes të kompanive me madhësi të ndryshme. Niveli i përgjithshëm i ulët i bashkëpunimit të bizneseve të serbëve-K në Veri me kompanitë në Jug është konfirmuar edhe në sondazhin e fundit të ICO-së në Veri të Kosovës⁶. Në anën tjetër, ne e kemi theksuar se bizneset e serbëve-K bashkëpunojnë në nivel të lartë me bizneset jo-shqiptare-K (56%), ndërsa 44% bashkëpunojnë në nivel të mesëm apo të ulët. Rezultatet janë të përkrahura edhe

6 Më shumë se 65% të serbëve-K mendojnë se nuk ka nevojë për ndonjë kontakt komercial me Jugun.

nga bizneset e shqiptarëve-K, ku rreth 86% të bizneseve të shqiptarëve-K deklaruan se bashkëpunojnë në nivel të ulët apo të mesëm me bizneset e serbëve-K, ndërsa rreth 14% të tyre kanë nivel të lartë të bashkëpunimit.

Përveç kësaj, bizneset u pyetën nëse bashkëpunimi është bërë në bazë formale apo joformale. Nga bizneset e serbëve-K, 87% deklaruan se bashkëpunojnë në nivel formal. Përdërisa vetëm 13% deklaruan se bashkëpunimi është joformal. Ngjashëm u deklarua edhe nga bizneset e shqiptarëve-K, ku rreth 88% të tyre deklaruan se bashkëpunimi është bërë në bazë formale, ndërsa vetëm 12% deklaruan se bashkëpunojnë në nivel joformal. Ky është një rezultat shumë i rëndësishëm dhe inkurajues, që e përkrah faktin se presioni i shoqërisë nuk është problem për tu marrë parasysh.

Bizneset e serbëve-K dhe shqiptarëve-K u pyetën rreth faktorëve që do ta ngritnin bashkëpunimin në mes të komuniteteve të ndryshme të biznesit në Kosovë. Bizneset e serbëve-K e konsiderojnë zhvillimin ekonomik në Kosovë (zhvillimi ekonomik krijon mundësi të reja për biznese, dhe rrjedhimisht krijon mënyra të reja të bashkëpunimit) si faktorin kryesor që ndikon në bashkëpunimin në mes të komuniteteve të ndryshme në Kosovë, të pasuar nga potencialet për shtim të përfitimit ekonomik përmes bashkëpunimit dhe themelimit të rrjeteve rajonale dhe qendrore të biznesit në mes të të gjitha komuniteteve të biznesit në Kosovë. Në anën tjetër, për bizneset e shqiptarëve-K, faktori më i rëndësishëm është potenciali për rritje të përfitimit ekonomik përmes bashkëpunimit. Zhvillimi ekonomik në Kosovë konsiderohet gjithashtu shumë i rëndësishëm, me pothuajse të njëjtin intensitet dhe themelimi i rrjeteve rajonale dhe qendrore të biznesit në mes të të gjitha komuniteteve të biznesit në Kosovë.

Qëllimi i studimit ishte edhe identifikimi dhe analiza se cilat janë pengesat për bashkëpunim në mes të bizneseve të serbëve-K dhe shqiptarëve-K. Në pyetësor pengesat për bashkëpunim duhej të rangoheshin nga 1 deri 5 (1 qëndronte për “nuk është pengesë” dhe 5 qëndronte për “pengesë shumë e madhe”). Ne kërkuam që bizneset t’i rangojnë, sipas mendimit të tyre, pengesat në vijim: 1. Presioni i shoqërisë nga komuniteti juaj, 2. Gatishmëria për bashkëpunim nga komunitetet tjera të biznesit, 3. Besimi, 4. Siguria, 5. Gjuha, dhe 6. Tregu i zi/krimi i organizuar. Pengesat janë shënuar individualisht nga 1 deri 5 dhe intensiteti është nxjerrë nga pikët e dhëna ndaj faktorëve në mënyrë që të vërehet cili faktor konsiderohet si më i rëndësishmi.


Për bizneset e serbëve-K, gjuha u rangua si pengesa më e madhe për bashkëpunim, e pasuar nga siguria, tregu i

zi/krimi i organizuar, dhe besimi. Gatishmëria nga komunitetet tjera të biznesit dhe presioni i shoqërisë u ranguan në pozitë më të fundit me më së paku pikë (shih figurën 4). Rezultatet tregojnë se ekziston gatishmëri në mesin e bizneseve të serbëve-K për bashkëpunim, dhe se nuk ka presion nga shoqëria, siç mund të pritej. Në anën tjetër, është interesante të shihet se gjuha është pengesa më e madhe për bashkëpunim, kur kemi parasysh se bizneset serbe (nga Serbia) dhe produktet e tyre janë prezente në masë të madhe në tregun Kosovor (më shumë se 300 milion euro në vit).

Në anën tjetër, për bizneset e shqiptarëve-K, tregu i zi/krimi i organizuar përfaqëson pengesën më të madhe për bashkëpunim, të pasuar nga besimi si pengesa e dytë, siguria, gatishmëria për bashkëpunim nga komunitetet tjera të biznesit dhe gjuha me intensitetin më të ulët.

Bizneset e serbëve-K u pyetën gjithashtu nëse i kanë regjistruar bizneset e tyre. Sipas rezultateve të sondazhit, 30% e tyre deklaruan se janë të regjistruar në Regjistrin e Biznesit të Kosovës, 38% deklaruan se janë të regjistruar në Regjistrin e Biznesit të Serbisë dhe 32% deklaruan se janë të regjistruar në të dy regjistrat. Kur i analizuam dallimet në përgjigje në mes të bizneseve në Veri dhe Jug, vërejtëm dallime të mëdha. Rreth 65% e bizneseve në Veri janë të regjistruar në Regjistrin e Biznesit të Serbisë, 32% në të dy regjistrat, dhe vetëm 2% në Regjistrin e Biznesit të Kosovës. Kurse, në Jug, situ-

Figura 5: Regjistrimi i bizneseve Serbe-K në Veri dhe Jug




Burimi: Sondazhi me biznese

ata është pothuajse e kundërta, ku 8% e bizneseve janë të regjistruara në Regjistrin e Biznesit të Serbisë (RBS), 56% në Regjistrin e Biznesit të Kosovës (RBK) dhe 31% në të dyja.


Pyetja e radhës në pyetësor kishte të bënte me pagimin e tatimit. Nga bizneset e serbëve-K 60% deklaruan se e paguajnë tatimin në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa 40% deklaruan se nuk paguajnë tatim fare. Nga ata që nuk paguajnë tatim, rreth 60% deklaruan se nuk

Figura 6: Pengesat për bizneset Serbe-K dhe bizneset Shqiptare-K në bërjen e biznesit në Kosovë



Burimi: Sondazhi me bizneset

Figura 7: Ndikimi i themelimit të qeverive të reja lokale në komunat e decentralizuara të Kosovës për bizneset Shqiptarë-K dhe Serbë-K



Burimi: Sondazhi me biznese

paguajnë për shkak se nuk janë të regjistruar si biznese formale, ndërsa pjesa tjetër deklaruan se nuk ka zyrë të administratës tatimore për t'i marrë formularët dhe për t'i bërë pagesat. Ne e shfrytëzuam këtë pyetje si pyetje miratimi edhe për regjistrimin e bizneseve. Dhe, nga rezultatet, mund të shohim se rreth 25% e të gjitha bizneseve të serbëve-K nuk janë të regjistruara fare, ku pjesa më e madhe është nga Veriu i Kosovës. Dallimi është i dukshëm kur krahasohet Veriu me Jugun në lidhje me pagesën e tatimit. Nga bizneset e intervistuar në Jug, 86% deklaruan se i paguajnë tatimet rregullisht në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa në Veri përqindja ishte 34%.

Një pjesë e rëndësishme e pyetësorit kishte të bënte me pengesat e përgjithshme për zhvillimin e biznesit në Kosovë. Bizneset e serbëve-K i ranguan ndryshe pengesat për zhvillimin e biznesit në krahasim me bizneset e shqiptarëve-K. Në pyetësor pengesat duhej të rangoheshin nga 1 deri 5, 1 për nuk është pengesë dhe 5 për shumë pengesë e madhe. Pengesa kryesore sipas bizneseve të serbëve-K në përgjithësi është korrupsioni. Korrupsioni pasohet nga shmangia fiskale dhe tregu i zi. Bizneset e serbëve-K e kanë ranguar konkurrencën jo-lojale në vendin e 3-të. Pengesat administrative paraqesin problem për bizneset e serbëve-K pasi që i kanë ranguar në pozitën e 4-të. Ligji perceptohet si një pengesë tjetër për biznese, në ndërkohë që bizneset e shqiptarëve-K e kanë ligjin si pengesën kryesore. Energjia elektrike, e cila është ranguar si pengesa e dytë nga bizneset e shqiptarëve-K, nga bizneset e serbëve-K është ranguar në vendin e 7-të. Ngjashëm me bizneset e shqiptarëve-K, grupi i fundit i pengesave që pasojnë janë shkathtësitë, të brendshme si: mungesa e internetit, niveli i ekspertizës së punëtorëve dhe shkathtësitë menaxhuese.

Ne i analizuam dhe i krahasuam të dhënat e bizneseve të serbëve-K në lidhje me pengesat e përgjithshme sa i përket pjesës veriore dhe jugore të Kosovës. Pjesa veriore e percepton shmangien fiskale dhe tregun e zi si pengesën udhëheqëse. Kjo pengesë është listuar si pengesa e pestë nga pjesa jugore. Korrupsioni është ranguar si pengesa më e madhe për zhvillimin e biznesit në pjesën jugore të Kosovës, ndërsa në pjesën veriore u rangua e dyta. Konkurrenca jo-lojale ishte pengesa e tretë më e madhe e shënuar nga pjesa veriore e Kosovës, krahasuar me këtë enklavat jugore e shënuan atë si pengesa e gjashtë e ranguar sipas rëndësisë. Konkurrenca jo-lojale ishte pengesa e tretë e shënuara nga pjesa veriore e Kosovës, krahasuar me këtë enklavat jugore e shënuan atë si pengesa e gjashtë e ranguar sipas rëndësisë. Ligji për pjesën veriore u rangua e gjashta; megjithatë, në pjesën jugore ishte e ranguar e dyta. Përveç kësaj, energjia elektrike u konsiderua si pengesë e madhe (e katërta) në enklavat jugore; ndërsa, në komunitetin verior u rangua në vendin e 11. Popullata e serbëve-K në Veri të Kosovës nuk paguan për energji elektrike e cila i sigurohet nga Korporata Energjetike e Kosovës; sidoqoftë, ata nuk kanë ndërprerje të energjisë elektrike dhe kjo është arsyeja pse ata nuk e konsiderojnë mungesën e energjisë elektrike si pengesë për ta zhvilluar biznesin.

Kur u pyetën për ndikimin e themelimit të qeverive të reja lokale në komunat e decentralizuara të Kosovës, 37% e bizneseve të serbëve-K deklaruan se krijimi i komunave të reja ka pas ndikim pozitiv në bizneset vendore, 13% deklaruan se ka pas ndikim negativ, ndërsa 50% deklaruan se nuk ka pas ndonjë ndikim. Megjithatë, është me rëndësi të përmendet se rreth 40% të bizneseve të serbëve-K nuk iu përgjigjën kësaj pyetje. Figura 7 paraqet të dhënat mbi ndikimin e themelimit të qeverive lokale në komunat e decentralizuara të Kosovës sipas bizneseve të shqiptarëve-K dhe serbëve-K.

Ne gjithashtu deshëm të shohim nëse ka dallime në opinionin në mes të bizneseve në Veri dhe Jug në lidhje me ndikimin e procesit të decentralizimit në zhvillimin e biznesit. Nga bizneset në Jug, 54% e bizneseve deklaruan se themelimi i qeverive të reja lokale nuk kishte ndikim, 16% besojnë se ka pas ndikim negativ dhe 28% besojnë se ka pas ndikim pozitiv në bizneset lokale. Në ndërkohë, nga bizneset në Veri, pothuaj se 80% nuk dhanë përgjigje, kështu që në këtë rast nuk kemi të dhëna për ta interpretuar këtë rezultat.

Të gjitha të dhënat e sondazhit mund të gjenden në ueb faqen në vijim: www.riinvestinstitute.org.

1.4 Përfundimet

Siç po shihet shumë qartë, intervenimet politike për ta shtyrë integrimin socio-ekonomik të komuniteteve etnike kane çuar dhe çojnë drejt një progresi shumë të ngadalshëm, sidomos kur e kemi parasysh Veriun e Kosovës. Krahas, ky studim tregon se ka mundësi reale për nxitjen e integrimit duke e shtuar bashkëpunimin në nivel biznesi, pasi që gatishmëria për bashkëpunim është e dukshme në të dy anët nëse ka mundësi për përfitim dhe zhvillim ekonomik.

Kur e shikon strukturën momentale të bizneseve të serbëve-K, në përgjithësi janë të vogla, me qasje të kufizuar në treg, qasje të kufizuar apo pa qasje në financa, mungesë e lidhjeve me rrjetet e bizneseve të shqiptarëve-K dhe qasje të kufizuar ndaj informatës. Ata janë të fokusuar kryesisht në tregun e tyre lokal dhe janë aktiv në tregti dhe shërbime, që nuk është as premtime për shkallë të lartë zhvillimi e as rritje të madhe në mundësi punësimi.

Momentalisht, niveli i bashkëpunimit ndër-etnik është shumë i ulët, përderisa bashkëpunimi brenda komunitetit të vet është dukshëm më i lartë. Pengesa kryesore që parandalon bashkëpunimin më aktiv të bizneseve të serbëve-K me bizneset e shqiptarëve-K është mungesa e besimit, izolimi, niveli i ulët i lirisë së lëvizjes, gjuha, performanca e dobët e ekonomisë, mungesa e ligjit dhe konkurrenca e padrejtë. Nuk është e qartë pse bizneset e serbëve-K e përmendin gjuhën si pengesë decisive për bashkëpunim, duke pas parasysh se bizneset nga Serbia janë të suksesshëm në shitjen e prodhimeve të tyre në tregun e Kosovës.

Në agrobiznes, pylltari dhe turizëm, ekziston potencial për bashkëpunim dhe përmes kësaj edhe zhvillim dhe krijim i vendeve të punës. Por ne anën tjetër, ndikimi i anasjelltë, d.m.th., nga zhvillimi i fuqishëm ekonomik në bashkëpunim më të mirë, pritët të jetë më i lartë, pasi që bizneset e serbëve-K përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të tregut. Prandaj, masat për ta nxitur zhvillimin e përgjithshëm ekonomik janë pjesë kryesore e rekomandimeve të këtij raporti.

Bashkëpunimi i 'pastër' i biznesit është shtytës shumë i fortë drejt krijimit të urave për ndarjet momentale në mes të grupeve etnike në Kosovë. Shumë njerëz që janë intervistuar apo kanë marrë pjesë në ndonjë mënyrë tjetër në këtë studim sugjerojnë fuqishëm se aktivitetet e biznesit nuk duhet të lidhen me probleme politike. Sidoqoftë, ne e theksojmë se bashkëpunimi i biznesit nuk mund të shihet i izoluar, dhe aspektet sociale si besimi dhe aspektet politike si institucionet qeveritare, të cilat duhet të jenë funksionale, luajnë rol të ngjashëm në mënyrë që t'i bëjnë të mundshme marrëdhëniet e biznesit që sigurojnë përfitim ekonomik në periudhë afat-gjate.

Në kapitullin e ardhshëm janë dhënë rekomandime se si të fuqizohet bashkëpunimi në mënyrë pozitive në mes të bizneseve të serbëve-K dhe shqiptarëve-K në mënyrë të qëndrueshme.

1.5 Rekomandimet

1.5.1 Rekomandimet për politika

Rekomandimet në vijim synojnë nivelin e politikave dhe rrjedhimisht Qeverinë e Kosovës. Premisa themelore e rekomandimeve është që Qeveria e Kosovës duhet t'i ndjekë politikat e veta për integrim të përcaktuara nga Plani i Ahtisaarit dhe të përfshira në legjislationin momental, por nevojitet të investojë në mënyrë më aktive në aktivitetet që ndërtojnë besimin si dhe në aktivitetet që e nxisin komunikimin dhe lidhjen në mes komuniteteve etnike në mënyrë më aktive. Për më tepër duhet të sigurojë që paanësia etnike të sigurohet në të gjitha institucionet dhe në të gjitha vendimet. Ajo duhet të:

- Zhvillojë një strategji të re për integrim që do ta vejë theksin në aktivitetet afat-mesme (3-5 vjeçare) drejt integritetit të komunitetit të biznesit të serbëve-K dhe do ta reduktojë izolimin e tyre. Bizneset duhet të përfshihen në procesin e elaborimit të strategjisë për integrim.
- Fuqizojë mjedisin e biznesit dhe të punojë drejt zhvillimit ekonomik në nivel makro-ekonomik përmes reduktimit të pengesave për zhvillimin e biznesit (si korrupsioni, konkurrenca e padrejtë dhe pengesat administrative), fuqizojë zbatimin e ligjit (në mes tjerash funksionimin e gjykatave, sigurinë dhe policinë dhe lirinë e lëvizjes) dhe institucionet funksionale (si doganat, administratën tatimore, shëndetësinë, arsimin).
- Ngritë besimin e komunitetit të serbëve-K në institucionet qendrore dhe lokale duke ofruar shërbime efektive publike në infrastrukturë, shëndetësi dhe arsim, një sistem të paanshëm gjyqësor dhe sigurinë e lëvizjes.
- Sigurojë pjesëmarrjen aktive të kompanive të pakicave në ofertat për tenderë qeveritarë dhe sigurojë vlerësim të paanshëm të ofertave dhe dhurimit të kontratave. Kjo do të ndihmojë më tej në ndërtimin e besimit në institucionet qeveritare.
- Shtojë aktivitetet për promovimin e biznesit duke i synuar në mënyrë specifike bizneset e serbëve-K, duke i ndërlidhur ato me bizneset tjera në Kosovë përmes ngjarjeve të ndryshme, panairove dhe aktiviteteve të tjera promovuese. Nga qeveria

kërkohet një qasje kreative dhe intensive në mënyrë që të binden bizneset e serbëve-K për të marrë pjesë në ngjarje të tilla dhe aktivitete të përbashkëta potenciale. Integrimi i përgjithshëm i biznesit kërkon ndihmë në ndërlidhjen përgjatë akterëve të ndryshëm etnik.

- Qeveritë lokale të komunave të serbëve-K duhet të jenë të hapura dhe t'i shtojnë stimulimet për investime nga jashtë dhe rrjedhimisht përmirësim të nivelit të përgjithshëm të bashkëpunimit. Punësimi në biznese të serbëve-K dhe shqiptarëve-K mund të jetë hapi i parë drejt praktikave të tjera të integritetit të biznesit, dhe ndryshimit në marrëdhëniet e besimit.

Në përgjithësi, këto rekomandime vlejnë për tërë Kosovën, duke përfshirë Veriun. Në Veri, megjithatë, zbatimi pengohet nga fakti se nuk janë të themeluara strukturat institucionale. Masat e ndërtimit të besimit janë veçanërisht të rëndësishme. Siç tregojnë edhe analiza e informatës kthyesë (analiza e sistemit), në mënyrë që të ndërtohet besimi, institucionet qeveritare duhet të jenë funksionale dhe popullata duhet ta ndjejë se institucionet janë duke punuar për interesin e popullatës. Rrjedhimisht, shërbimet qeveritare duhet të zgjerohen në Veri sa të jetë e mundur. Rekomandimet në lidhje me politika në vijim e synojnë në mënyrë specifike Veriun e Kosovës:

- Të trajtoje bizneset serbe nga Veriu në mënyrë të njëjtë si bizneset tjera në Kosovë, nëse ato janë plotësisht të regjistruara në administratën e Kosovës. Të merren parasysh në tenderë qeveritare dhe të inkurajohen të aplikojnë për to.
- Nëse i gjithë dokumentacioni është në rregull, tregtia e produkteve në mes të Veriut dhe pjesës tjetër të Kosovës, duhet të bëhet e mundur dhe madje të inkurajohet. Dëshmitë gojore nga të intervistuarit sugjerojnë se bizneset nga Veriu po kanë vështirësi në transportimin e produkteve të tyre në Jug, madje edhe me dokumentacion të vlefshëm.
- Krijimi i sigurisë dhe lirisë së lëvizjes për qytetarët nga Veriu në tërë Kosovën.

1.5.2 Rekomandimet për akterët e biznesit

Rekomandimet për akterët e biznesit kryesisht i synojnë asociacionet e biznesit, odat ekonomike dhe agjencitë investuese. Por edhe bizneset individuale mund të luajnë rol në përmirësimin e marrëdhënieve në mes të komuniteteve të biznesit të të dy grupeve etnike.

- Asociacionet e biznesit në Kosovë duhet të luajnë rol aktiv drejt integritit të bizneseve të serbëve-K nga Jugu dhe Veriu i Kosovës. Mënyrë e shpejtë, anëtarësimi i bizneseve të serbëve-K në këto asociacione është i ulët. Në mënyrë që të përmirësohet niveli i pjesëmarrjes, këshillohet përfshirja e pjesëmarrësve të serbëve-K në menaxhmentin e asociacioneve. Kjo do ta ngritë besimin e bizneseve të serbëve-K në asociacione.
- Asociacionet duhet të organizojnë panairë të përbashkët me fokus në promovimin e prodhimeve vendore, potencialit dhe stimulimeve të tjera për bashkëpunim.
- Agjencitë investuese duhet t'i promovojnë mundësitë e biznesit në rajonet e serbëve-K me theks të veçantë në përparësitë krahasuese të këtyre rajoneve.

1.5.3 Rekomandimet për donatorët ndërkombëtarë

Në vijim, janë paraqitur një numër rekomandimesh për donatorët ndërkombëtarë. Intervenime specifike mund të planifikohen, si projekte individuale apo si komponentë të ndara të projekteve më të mëdha. Rekomandimet e synojnë tërë Kosovën, duke përfshirë Veriun sa më shumë që të jetë e mundur. Në vijim janë dhënë rekomandime dhe konsiderime specifike strategjike për Veriun.

- Përkrahje qeverisë në zbatimin e rekomandimeve për politikën të paraqitura më lart.
- Themelimi i programeve për përkrahje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për zhvillimin e tregut, duke u fokusuar në sektorët me potencial të lartë për integrim (kryesisht agrobizneset, pylltaria dhe turizmi). Përdorimi i qasjes sistematike (p.sh. Qasja e Krijimit të Tregjeve Funksionale për të Varfrit), duke përfshirë veprime afirmative për ngritjen e

bashkëpunimit në mes të komuniteteve etnike, për shembull përmes përkrahjes së aktiviteteve të përbashkëta.

- Aktivitetet drejt reduktimit të izolimit të komunitetit të biznesit të serbëve-K. Nxjitja e integritit në asociacione të biznesit, oda ekonomike, aktivitete për promovimin e tregtisë dhe biznesit, etj.
- Fuqizimi i kapaciteteve të komunave në zhvillimin ekonomik lokal dhe rajonal në pajtim me procesin e vazhdueshëm të decentralizimit me fokus në komunitatet e reja serbe.

Duke e pasur parasysh situatën kaotike në Veri të Kosovës, janë propozuar rekomandimet në vijim në mënyrë specifike për Veriun

- Përkrahja e iniciativave që funksionojnë drejt integritit, në nivel të biznesit (fonde nismëtare, trajnime, ndërlidhje me jugun), nivel të shoqërisë (pajtim dhe ndërtim i besimit) dhe në nivel institucional (regjistrim i biznesit, lëshimi i ID-ve të Kosovës, etj.). Duhet të identifikohen dhe fuqizohen modelet që janë të favorshme për integrimin në Veri, modelet që shkojnë kundër integritit duhet të dobësohen. Pasi që këto modele po ndryshojnë shpesh për shkak të situatës kaotike dhe të turbullt, nuk mund të jepen opsione konkrete; vërtet, intervenimet duhet të bazohen në realitetin momental përmes analizës së detajuar në terren.
- Lansimi i një kampanje informative për t'i informuar njerëzit në mënyrë sa më të paanshme për mundësitë në Kosovë.
- Zhvillimi i strategjisë së përbashkët në Veri në mes të të gjithë donatorëve prezent dhe koordinimi i intervenimeve të tyre në mënyrë që të mos dyfishohen aktivitetet ose edhe më keq të mos punojnë kundër intervenimeve të donatorëve tjerë. Strategjia duhet të marrë parasysh principet për vendim marrje në sisteme kaotike siç është paraqitur në pjesën e metodologjisë së këtij raporti.

Për shkak të karakteristikave të qarta të sistemit kaotik në Veri, duhet të zbatohen principet në vijim për secilin intervenim:

- Konteksti në Veri është i ndryshëm nga pjesa tjetër e vendit, siç është paraqitur në këtë raport. Andaj, zgjerimi i thjeshtë i programeve nga Jugu në Veri bart me vete një rrezik të trashëguar që intervenimet nuk do të kenë sukses apo madje edhe mund ta dëmtojnë qëllimin e integritetit. Për Veriun, duhet të bëhet analizë e veçantë e kontekstit dhe zgjidhjet dhe intervenimet duhet të bazohen në të.
- Efektet e secilit intervenim duhet të monitorohen nga afër dhe vazhdimisht. Intervenimet që e përkrahin integritetin duhet të fuqizohen; intervenimet që mund të jenë të dëmshme për procesin e integritetit duhet të ndërkyhen shpejt apo të ndryshohen. Intervenimet mund të kthehen shpejt nga një lloj në tjetrin. Duhet të aplikohet qasja “mos-bëj-dëm”.
- Projektet duhet të bëjnë një analizë të kujdesshme të rrezikut kur i zgjedhin partnerët lokal pasi që ka dëshmi narrative për njerëz me ndikim në Veri të cilët gjithnjë e më shumë po i marrin grantet e donatorëve dhe po i shfrytëzojnë kryesisht për përfitim të tyre personal. Donatorët duhet t'i shkëmbejnë përvojat e tyre me partnerët lokal për ta përmirësuar shpërndarjen e drejtë të fondeve të donatorëve.
- Duhet të sigurohet zbatimi i vazhdueshëm i menaxhimit të projekteve të ndjeshme në konflikt për të gjitha intervenimet në Veri.

1.5.4 Opsionet për aktivitete konkrete

Në këtë pjesë, do të propozohen një numër aktivitete konkrete që janë në pajtim me rekomandimet më lart.

- Qeveria e Kosovës me ndihmën e donatorëve do të mund të sigurojë qendra informative, pika “nje-stop” (one-stop shops) dhe qendra të tjera shërbimesh në mënyrë që ta nxisë formalizimin e bizneseve të serbëve-K dhe ta ndihmojë regjistrimin dhe aktivizimin e bizneseve të reja. Këto qendra do të siguronin shërbime dhe informata relevante në lidhje me ligjet, kërkesat

operacionale dhe përfitimet nga regjistrimi në agjensite shtetërore (aplikimi për tenderë qeveritare, subvencione qeveritare, kredi bankare, etj.).

- Qeveria e Kosovës me ndihmën e donatorëve do të mund ta krijonte një fond për integritet dhe bashkëpunim ekonomik të komuniteteve të biznesit me qëllim të përkrahjes së:
 - Promovimit të mundësive për investime për bizneset e serbëve-K përmes, për shembull, krijimit të agjencive për bashkëpunim të bizneseve ndër-etnike, krijimit të aleancave të biznesit, pjesëmarrjes në kampanja për promovim e investimeve, tregtisë dhe misionëve të investimeve të Kosovës në nivel ndërkombëtar;
 - Sigurimit të përkrahjes për stimulime fiskale për bizneset prodhuese të serbëve-K të cilat janë të regjistruara në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës dhe bizneseve të cilat veprojnë si rezultat i investimeve të përbashkëta me partnerë biznesi të shqiptarëve-K;
 - Inkurajimit të përfshirjes së bizneseve të serbëve-K në aplikimin për tenderë qeveritarë si të vetëm apo në bashkëpunim me biznese të shqiptarëve-K, sidomos në pjesëmarrjen në procesin e privatizimit të SOE dhe POE.
- Përkundër pjesëmarrjes së komunitetit të serbëve-K në pozita kyçe qeveritare është e domosdoshme të sigurohet pjesëmarrje adekuate në pozita më të ulëta qeveritare me anë të së cilës do të demonstrohej integriteti administrativ dhe do të nxitej një trajtim më i paanshëm i vendimeve. Në këtë aspekt është e nevojshme të sigurohet pjesëmarrja e përfaqësuesve të serbëve-K sidomos në agjencitë relevante për zhvillim të tregtisë dhe biznesit si dhe të sigurisë dhe lirisë së lëvizjes, si administrata tatimore, shërbimet doganore, policia, etj.
- Sigurimi i amnistisë fiskale për bizneset joformale që janë të gatshme për ta formalizuar biznesin e tyre në mënyrë që të inkurajohet transformimi dhe formalizimi i bizneseve.

PJESA II

2.1 Metodologjia

2.1.1 Hulumtimi i materialeve të shkruara

Hulumtimi i materialeve të shkruara përbën identifikimin dhe rishikimin e literaturës kryesore ekzistuese për kornizën ligjore dhe të politikave, një rishikim të analizave dhe hulumtimeve tashmë të ndërmarra për këtë çështje dhe dokumentet tjera të printuara, elektronike, të publikuara dhe të papublikuara si edhe dokumentet e hulumtimeve ndërkombëtare, rajonale dhe vendore nga institucionet ndërkombëtare dhe vendore, dhe OJQ-të ndërkombëtare dhe vendore.

Analizat e hulumtimit të materialeve të shkruara u shfrytëzuan si bazë për informata të kontekstit (kapitulli 3 i raportit), përshkrimin e sistemit dhe zhvillimin e pyetësorit për sondazhin dhe intervistat me informatorët kyç. Informatat e mbledhura gjatë hulumtimit të materialeve të shkruara janë shfrytëzuar edhe për identifikimin e palëve me interes dhe zgjedhjen e informatorëve kyç. Kriteret për zgjedhjen e informatorëve kyç janë bazuar kryesisht në interesimin dhe njohuritë mbi kontekstin e palëve me interes si edhe përfshirja në lloje të ndryshme të iniciativave për integrim ekonomik të komunitetit të serbëve-K në të kaluarën dhe të ardhmen në Kosovë.

2.1.2 Intervistat me informatorët kyç

Intervistat me palët me interes janë bazuar në shkëmbimin e informatave mbi situatën momentale sa i përket politikave, rregulloreve, zhvillimit të tregut, praktikave më të mira dhe mësimet të nxjerra. Në mënyrë që të arrihet një pamje më reale e qëndrimeve të tyre janë bërë nëntëmbëdhjetë intervista të semi-strukturuara me përfaqësues të institucioneve të Kosovës, organeve ndërkombëtare, organeve serbe, organizatave të shoqërisë civile, asociacioneve të biznesit, si edhe me përfaqësues të bizneseve të shqiptarëve-K dhe serbëve-K (për listën e plotë të të intervistuarve ju lutem shikoni shtojcën 1). Sidoqoftë, ishte e qartë se përgjigjet ishin kryesisht të bazuara në perceptimin personal të individëve pasi që ka mungesë të dukshme të hulumtimeve të bëra mbi këtë çështje. Në veçanti, kishte mungesë të informat-

ave mbi strukturën aktuale të bizneseve të serbëve-K dhe potencialit të tyre ekonomik.

Në mënyrë që të sigurojmë nivel maksimal të sinqeritetit të mundshëm, intervistat me përfaqësues të bizneseve të serbëve-K nga kjo pjesë e Kosovës janë bërë nga konsulenti ndërkombëtar në bashkëpunim me Avenija. Duke e pasur parasysh natyrën e ndjeshme të temës, bisedat nuk janë regjistruar dhe jemi munduar të mbajmë shënime të cilat më vonë janë shkruar për analizë sistematike kualitative të të dhënave.


2.1.3 Sondazhi

Raporti paraqet rezultatet nga një sondazh me 300 biznese (menaxherë), të cilët reflektuan mbi informatat në lidhje me perceptimin e tyre për ndërveprimin ndër-etnik të bizneseve, pengesat dhe mundësitë për zhvillimin e biznesit, stimulimet për bashkëpunim të biznesit dhe situatën momentale të biznesit të tyre. Perceptimet është dashur të vlerësohen edhe për bizneset e serbëve-K edhe të shqiptarëve-K në Kosovë. Për ta bërë këtë janë organizuar 100 intervista sondazhi me bizneset e shqiptarëve-K dhe 200 intervista sondazhi me bizneset e serbëve-K.

Në mënyrë që të jemi në gjendje të bëjmë dallimin në mes të bizneseve në Veri të Kosovës dhe në pjesët tjera, është bërë marrja e mostrave të stratifikuara duke i marrë parasysh nga 100 biznese nga të dy rajonet. Për shkak të Kosovës paralele dhe institucioneve serbe aktive në të njëjtën hapësirë, eksiton edhe një sistem i dyfishtë i regjistrimit të bizneseve. Si pasojë, bizneset e serbëve-K janë të regjistruara vetëm pjesërisht në Agjencinë për Regjistrim të Biznesit në Kosovë. Fatkeqësisht, nuk patëm mundësi ta marrim numrin e kompanive të regjistruara në Regjistrin e Biznesit të Serbisë. Si rezultat, nuk është i ditur numri i bizneseve aktuale të serbëve-K në Kosovë. Andaj, u zgjodhën të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës në kombinim me identifikimin e bizneseve në terren nga Avenija për zgjedhjen e bizneseve.

Edhe pse e kuptojmë se 100 kompani nuk është një mostër përfaqësuese për popullatën e bizneseve të shqiptarëve-K në Kosovë, një zgjedhje e tillë është bërë me qëllim që të kuptojmë për anën e medaljes

Figura 8: Korniza Cynefin. Domenet e njohura dhe të njohshme poashtu renditen si të thjeshta dhe të komplikuar, respektivisht. Ilustrimi i majtë përshkruan katër domenet, ndërsa ilustrimi i djathtë përshkruan ndikimin e ndërlidhjeve dhe shkallën e qendërsisë.



Burimi: Kurtz and Snowden, 2003

së shqiptarëve-K. Andaj, është nxjerrë një mostër nga grupi i bizneseve me probabilitet më të lartë për bashkëpunim me bizneset e serbëve-K, që përbën në përgjithësi kompani të mëdha të prodhimit dhe tregtisë. Mostra prej 100 bizneseve për intervista son-dazhi me bizneset e shqiptarëve-K është marrë nga 600 bizneset më të mëdha të prodhimit dhe tregtisë nga regjistri i Administratës Tatimore të Kosovës.

Për zgjedhjen e bizneseve është marrë, aq sa ka qenë e mundur, mostër e rastësishme nga lista në dispozi-cion e bizneseve. Popullata e synuar për sondazh janë bizneset aktive që veprojnë në Kosovë (duke siguruar balanc proporcional në mes të rajoneve të ndryshme). Madhësia e mostrës lejon disagregimin e të dhë-nave duke u bazuar në këto grupe: bizneset e sh-qiptarëve-K, bizneset e serbëve-K në Veri të Kosovës, bizneset e serbëve-K në rajonet tjera të Kosovës.

2.1.4 Analiza e studimit të rasteve

Informatat nga intervistat dhe sondazhi janë shfrytë-zuar për t'i identifikuar rastet potenciale për studim, duke u bazuar në bashkëpunimin e suksesshëm në mes të bizneseve të serbëve-K dhe shqiptarëve-K në Kosovë. Janë identifikuar pesë raste studimi nga rajone të ndryshme për ta përfaqësuar modelin e bashkëpunimit ndëretnik të bizneseve për bizneset

tjera në Kosovë. Janë përdorur intervista të thella si metodologji për mbledhjen e të dhënave nga për-faqësuesit e katër bizneseve dhe është organizuar një grup fokusi në bashkëpunim me Komunën e Shtërpc-es. Grupi i fokusit është përbërë nga bizneset e pro-dhimit të frutave të malit si përfaqësues më të mirë të bashkëpunimit ndëretnik ku bizneset e serbëve-K dhe shqiptarëve-K janë të përfshirë në mënyrë të bara-bartë.

Metodologjia e studimit të rasteve nuk është bazuar në pyetësorë apo instrumente sondazhi në mënyrë që të mos paracaktohen çështje apo faktorët primarë. Në vend të saj, janë zhvilluar intervista të hapura dhe të udhëzuara nga udhëzimet e studimit të rasteve të har-tuara paraprakisht nga ekipi, me një listë të pyetjeve relevante të kategorizuara.

2.1.5 Analiza e sistemeve

2.1.5.1 Hyrje: nga e thjeshta deri te kompleksja

Metodologjia e përdorur për Analizën e Sistemeve është bazuar në punën e Peter Frischknecht dhe Bar-bara Schmied (2009) nga Departamenti i Shkencave Mjedisore në Institutin Federal Zviceran të Teknolog-

jisë Cyrih. Ajo është kombinuar me konceptin e kuptimit dhe zhvillimit të strategjisë në mjedise komplekse dhe të komplikua të quajtur Korniza Cynefin, të zhvilluar nga Cynthia F. Kurtz dhe Dave J. Snowden (2003) në IBM Global Services⁶.

Të dy publikimet e bëjnë dallimin në mes të situatave që janë të thjeshta, të komplikua apo komplekse. Kurtz dhe Snowden shkojnë më tutje dhe i shtojnë edhe situatat kaotike. Dallimet kryesore në mes të domeneve janë numri i elementeve në sistem që merret parasysh si edhe ndërlidhja e tyre. Në përgjithësi, sa më shumë elemente në një sistem dhe më shumë lidhje çojnë drejt vështirësisë më të madhe për ta përcaktuar shkaktuan dhe efektin dhe rrjedhimisht për ta parashikuar sjelljen e sistemit. Një aspekt tjetër definues është shkalla e qendrores, d.m.th. nëse ekziston fuqia qendrore e cila e kontrollon sistemin. Raporti në mes të shkakut dhe efektit bëhet i papara-shikuar në sisteme komplekse dhe në sisteme kaotike shkatërrohet plotësisht. Në secilin domen nevojiten modele të ndryshme vendimi. Korniza Cynefin është e paraqitur në Figurën 8.

Dy domenet që janë më relevant për sistemet që vlerësohen në këtë raport janë domeni kompleks dhe kaotik.

Domeni kompleks: Raportet shkak dhe efekt shpesh nuk mund të vlerësohen për shkak të numrit të madh të agjentëve dhe numrit të madh të raporteve. Modelet që dalin mund të vlerësohen vetëm në mënyrë koherente në retrospektivë por nuk mund të parashikohen. Nëse një strategji bazohet në modele koherente në retrospektivë vetëm sa do t'i konfrontojë modelet e reja dhe të ndryshme për të cilat procedurat e dhëna nuk janë të përgatitura mirë. Rrjedhimisht, kategorizimi apo teknikat analitike nuk janë të përshtatshme. Modeli i vendimit këtu është të krijohen prova për të bërë modele apo modele potenciale që janë më të dukshme para se të ndërmerret ndonjë veprim. Pasi të vërehen modelet, përgjigja është të stabilizohen këto modele që janë parë si të dëshirueshme, të destabilizohen ato që nuk janë të dëshirueshme dhe të ushqehet hapësira në mënyrë që modelet e dëshirueshme të kenë më shumë mundësi të shfaqen.

Domeni kaotik: Në domenin kaotik, nuk ka raporte të dukshme në mes të shkakut dhe efektit dhe sistemi është i turbullt. Nuk ka kohë të hulumtohet ndryshimi.

Modeli i vendimit në këtë domen është të veprohet, shpejt dhe me vendosmëri, të reduktohet turbulenca; dhe pastaj menjëherë të vërehet reagimi ndaj intervenimit në mënyrë që të reagohej në mënyrë të duhur. Intervenimet autoritare për ta kontrolluar hapësirën, apo intervenimet e shumëfishta alternative mund të përdoren për të krijuar modele të reja dhe kështu të lëvizet situata në hapësirë komplekse.

2.1.5.2 Pasqyrë e analizës së sistemeve

Përderisa korniza Cyniefin ofron bazën për ta karakterizuar një situatë të dhënë, analiza dinamike e sistemit (ADS) e prezantuar nga Frischknecht dhe Schmied ofron një qasje gjithëpërfshirëse për vlerësimin e një sistemi dhe kuptimin e dinamikave të tij. Andaj, ajo mund të marrë formë të ndryshme për t'i përkrahur modelet e vendimit për lloje të ndryshme të sistemeve.

Në sistemet e komplikua, qëllimi është të zhvillohet një model i sakt i sistemit, duke qenë në gjendje të simulohet dhe rrjedhimisht të parashikohet sjellja e sistemit. Në sistemet komplekse, si ky që e kemi në dorë, analiza e dinamikës së sistemeve shfrytëzohet për t'i identifikuar dhe shpjeguar modelet dhe mekanizmat ekzistues që e mbajnë modelin të stabilizuar. Në këtë kontekst, nuk është qëllimi i analizës të paraqitet një model gjithëpërfshirës i sistemit por të reduktohet kompleksiteti në atë mënyrë që modelet e dukshme dhe arsyetimi i tyre në sistem të jenë më të qasshme dhe të dobishme pa e mohuar dinamikën e përgjithshme të sistemit.

Pasi që intervenimet në sisteme kaotike janë të udhëhequra nga veprime të drejtpërdrejta dhe të vendosura, korniza e analizës si ajo e analizës së dinamikës së sistemeve nuk ndihmon shumë. Në këtë rast është më rëndësi të ketë një sistem të ndjeshëm monitorimi për ta vërejtur reagimin e sistemit ndaj intervenimeve. Metodologjia e analizës si ajo që është prezantuar këtu mund të shfrytëzohet vetëm kur intervenimet e shtojnë sistemin në domenin kompleks.

Të gjithë hapat e ADS janë prezantuar në Figurën 1. Nga këndvështrimi metodologjik, identifikimi dhe strukturimi i problemit bëhet në punëtori ekipore ku identifikohen gjithashtu fushat ku ka nevojë për më shumë informata. Të dhënat për t'i përmbushur këto zbrazëtira në mënyrë që të bëhet analiza e palëve me interes, analiza ekonomike, analiza e rregullave dhe rregulloreve si edhe analiza e çështjeve ndërlidhëse

⁶ IBM – Korporata Ndërkombëtare e Makinave të Biznesit

mbledhjen nga metoda e përshkruar më lart në këtë kapitull.

Hapi për t'i kuptuar ndër-varësitë është i ndarë në dy analiza kryesore, analiza e ndjeshmërisë dhe analiza e zbratëzive të informatës kthyesë, të prezantuara më detajisht në vijim.

Pasi që qëllimi i këtij studimi është prezantimi i rekomandimeve, hapat e dizajnit të intervenimit, vlerësimit dhe zbatimit nuk janë marrë parasysh tani.

2.1.5.3 Analiza e ndjeshmërisë

Duke u bazuar në informatat e mbledhura gjatë hapa-ve të mëparshëm është definuar një set i faktorëve të ndikimit për ta shpjeguar sistemin. Siç është përmendur më parë, qëllimi i kësaj analize nuk është t'i mbulojë të gjithë faktorët dhe dinamikat e mundshme në mënyrë gjithëpërfshirëse, por të paraqesë modelet më të rëndësishme. Andaj, për këtë dhe për arsye praktike, numri i faktorëve të ndikimit duhet të mbahet sa më i vogël që është e mundur, por në të njëjtën kohë aq i madh sa është e domosdoshme për ta paraqitur një pasqyrë të kuptimshme.

Në mënyrë që të kuptohen ndërvarësitë, ndikimi i secilit faktor ndikues në secilin faktor tjetër vlerësohet në një shkallë relative të 0 (aspak), 1 (dobët), 2 (mesatar) dhe 3 (fortë) dhe prezantohet në të ashtuquajturën matricë të ndikimit. Shuma e të gjitha ndikimeve të një faktori specifik të ndikimit e përcakton nivelin e aktivitetit, d.m.th. sa ka ndikim në sistem. Faktorët e ndikimit apo variablat, siç quhen gjithashtu prë shkak të natyrës së tyre të ndryshueshme, mund të plotësohen pastaj në të ashtuquajturin diagram të ndikimit, një grafik me pasivitetin e boshtit x dhe aktivitetin e boshtit y. Duke e përdorur aktivitetin dhe pasivitetin mesatar për ta ndarë diagramin e ndikimit në katër katrorë, variablat mund të karakterizohen si aktive, kritike, pasive apo në pritje, varësisht nga katrori ku janë të vendosura.

Faktorët aktiv: Këta faktorë kanë ndikim të madh në sistem por ndikohen dobët nga ai. Ata mund të shfrytëzohen si pika krahasimi.

Faktorët pasiv: Këta faktorë kanë ndikim të dobët në sistem por ndikohen shumë nga ai. Ata mund të shihen si indikatorë.

Faktorët kritik: Këta faktorë kanë ndikim të madh në sistem dhe ndikohen shumë nga ai. Ata janë shtytësit

dhe katalizatorët e sistemit. Kur ndikohet në ta, duhet të kemi parasysh rrezikun e tej ngrohjes së sistemit.

Faktorët në pritje: Këta faktorë kanë ndikim të dobët në sistem dhe ndikohen dobët nga ai. Ata kryesisht shihen si stabilizues të sistemit.

2.1.5.4 Analiza e zbratëzive të informatës kthyesë

Në analizën e zbratëzive të informatës kthyesë, bëhet një diagram i cili përmban vetëm ndikimet më sinjifikante të identifikuar në analizën e ndjeshmërisë të përshkruar më lart. Këto ndikime vizatohen si shigjeta në mes të faktorëve të ndikimit. Ndikimi mund të jetë protagonist, d.m.th. të dy faktorët ndryshojnë në të njëjtin drejtim, apo antagonist, d.m.th. variablat ndryshojnë në drejtim të kundërt. Kjo vërehet nga shenja plus apo minus afër majës së shigjetës.

Duke u bazuar në këtë diagram të ndikimit, mund të identifikohen zbrazëti të informatës kthyesë. Ekzistojnë dy lloje themelore të zbratëzive të informatës kthyesë, zbratëtitë përforcuese dhe zbratëtitë frenuese. Për të përcaktuar nëse një zbrazëti është përforcuese apo frenuese duhet të merret parasysh numri i shigjetave negative. Nëse ky numër është çift, zbrazëti është përforcuese, nëse është tek atëherë ajo është frenuese.

Zbratëtitë përforcuese mund të jenë edhe qarqe të drejta edhe të shtrembëra, varësisht nga dinamika e sistemit. Një qëllim i mundshëm i intervenimit mund të jetë të ndryshohet dinamika e zbratëzive të tilla nga qarku i shtrembër në atë të drejtë apo të forcohet qarku i drejtë në krahasim me pjesën tjetër të sistemit. Por zbratëtitë përforcuese mundën edhe ta destabilizojnë sistemin nëse dalin jashtë kontrollit.

Zbratëtitë frenuese e stabilizojnë sistemin. Ato e kundërshtojnë çdo reagim ekstrem, edhe në pozitive ashtu edhe në negative. Zakonisht këto zbrazëti janë të rëndësishme nëse pyesim pse një sistem nuk reagon ndaj intervenimeve tona. Zakonisht ka zbrazëti të informatës kthyesë që e frenon reagimin e sistemit ndaj intervenimit dhe e mban atë në gjendjen momentale.

2.2 Analiza e sistemeve

2.2.1 Karakterizimi i sistemit

Sistemi që është analizuar në këtë studim ka të bëjë me bashkëpunimin ekonomik në mes të komunitetit të serbëve-K dhe shqiptarëve-K në Kosovë. Ky bashkëpunim ndikohet nga faktorë të ndryshëm jashtë sferës ekonomike, në mënyrë specifike nga sferat e shoqërisë, politikës, institucioneve dhe sektorit joformal. Për më tepër, sistemi ndikohet në masë të madhe nga ngjarjet e fundit historike si lufta në Kosovë në vitin 1999, tensionet etnike në Kosovë në pranverë të vitit 2004 apo barrikadat e vendosura nga pakica serbe në Kosovën veriore në korrik 2011. Fusha të ndryshme janë të populluara nga akterë të ndryshëm me agjenda shumë heterogjene që nga politika dhe tregtia deri te interesat personale. Sistemi shfaq karakteristika të tilla si – numri i madh i akterëve me interesa të ndryshëm dhe faktorë të tjerë me ndikim si edhe ndër-lidhshmëri të madhe të të gjithë faktorëve – karakterizohen si sisteme komplekse; rrjedhimisht janë të paparashikueshme dhe nuk mund të reduktohen në një model të thjeshtë.

Duhet të bëhet një dallim i qartë në mes të situatës në Jug, ku mund të identifikohen modelet e qarta të bashkëpunimit dhe mos-stimulimi pak a shumë i qartë për bashkëpunim, dhe në Veri, i cili shfaq vetëm një shkallë të kufizuar të modeleve koherente dhe modelet e vetme që raportohen në mënyrë koherente nga burime të ndryshme janë ato të krimit të organizuar, njerëzit me ndikim – politika dhe dhuna. Intervënime të kryengritjeve të përsëritura dhe politike dhe administrative nga Qeveria e Kosovës, Qeveria e Serbisë si edhe komuniteti ndërkombëtar e destabilizojnë situatën edhe më shumë. Andaj, Veriu i Kosovës shfaq karakteristika të qarta të një sistemi kaotik ku raportet në mes të shkakut dhe efektit janë të vjetëruara, situata është e turbullt dhe të gjitha modelet që shfaqen pengohen shpesh nga ngjarje politike, shpesh

të dhunshme. Ngjarjet e vogla mund të çojnë drejt pengesave të mëdha që mund t'i ndryshojnë plotësisht prioritetet e intervenimit. Duke u bazuar në këto gjëra për t'i marrë parasysh, modele dhe strategji të ndryshme të vendimit duhet të zbatohen për të zhvilluar rekomandime dhe intervenime për Veriun dhe Jugun.

Për shkak të karakteristikave të sistemeve kaotike, analiza e thellë në Veri nuk do të çojë drejt asnjë gjetje të dobishme, pasi që modelet shpërbëhen shpejt dhe çdo kuptim i marrë nga analiza apo provë do të jetë e padobishme brenda një kohe të shkurtër për shkak të turbulencave të mëdha në sistem. Rrjedhimisht, ADS ka qenë e fokusuar në Jug. Sidoqoftë, janë marrë parasysh ide për intervenime të mundshme në Veri të bazuara në modelin e vendimit të dhënë nga korniza Cynefin dhe do të paraqiten në kapitullin e rekomandimeve.

2.2.2 Përcaktimi i modelit të sistemit

Hapi i parë i SDA është të përcaktohen variablat që e formësojnë sistemin. Kur punohet në sisteme komplekse, është qëllim i SDA të zbulohen modele dhe të bëhet dinamika dhe ndikimet që i ndërtojnë këto modele të dukshme dhe të qasshme, e jo të ndërtohet një model përfaqësues që reflekton çdo aspekt të sistemit. Andaj, qëllimi ynë ishte të përdorim vetëm një numër të vogël të variablave më të rëndësishme për ta përshkruar sistemin. Një numër i variablave që janë shumë të ndërlidhura janë kombinuar në një për ta rritur qartësinë, kështu që për shembull performanca e sektorëve ku bashkëpunimi është më i zakonshëm dhe performanca e bizneseve individuale, pasi që edhe ashtu janë të ndërlidhura, janë marrë së bashku në një variabël të performancës ekonomike. Janë definuar 16 variabla në përgjithësi. Ato janë paraqitur dhe shpjeguar në Tabelën 1.

Tabela 1: Përshkrimi i variablave të përdorura për analizën e dinamikës së sistemit.

Nr	Variabla	Përshkrimi/Treguesi
1	Besimi në institucionet e Kosovës	Pjesa e bizneseve dhe komunitetit të përgjithshëm që shprehin besim në institucionet e Republikës së Kosovës si ministritë, organizatat qeveritare, gjykatat, liria e tregut, etj
2	Pranimi i statusit politik	Pjesa e Serbëve-K që e pranojnë statusin politik të pavarësisë së Republikës së Kosovës.
3	Zbatimi i ligjit	Shkalla e zbatimit të ligjit, veçanërisht zbatimi i kontratave, të drejtat mbi pronën, mbledhja e tatimeve, regjistrimi i bizneseve, siguria e aseteve dhe siguria personale.
4	Presioni i shoqërisë	Shkalla deri në të cilën bizneset perceptojnë se janë nën presion nga shoqëria për të mos bërë biznes me kompanitë që janë pronë e njerëzve nga etnitë tjera.
5	Politikat anti-integruese	Shkalla e ndikimit të grupeve të interesit që promovojnë politikë anti-integruese dhe nacionalizëm të bazuar në patriotizëm apo për shkak se përfitojnë nga situata momentale. Kombinimi i të dyjave, grupeve me ndikim politik dhe të biznesit.
6	Politikat pro-integruese	Shkalla e ndikimit të aktiviteteve politike dhe grupeve të interesit që nxisin integrimin e pakicave.
7	Performanca ekonomike	Performanca ekonomike e bizneseve individuale (qarkullimi) që reflekton në rritjen e sektorëve ku bashkëpunimi është më i zakonshëm (p.sh. agrikultura, turizmi).
8	Izolimi i komunitetit serb	Izolimi i komunitetit Serb-K përmes mbulimit të kufizuar nga mediat në gjuhën serbe, siguria e ulët dhe liria e kufizuar e lëvizjes, mungesa e qasjes në rrjete të biznesit dhe panairëve tregtare, mungesa e informacionit në gjuhën serbe për mundësitë e tregut, perceptimi i cilësisë së produkteve të K-Serbe, etj.
9	Niveli i bashkëpunimit	Numri i bizneseve Shqiptare-K dhe Serbe-K që bashkëpunojnë në marrëdhënie biznesi të cilat sigurojnë përfitim ekonomik për të dy palët.
10	Konkurrenca e padrejtë	Humbja e biznesit përmes ekonomisë joformale, shmangia e tatimit, marrëveshjet/monopolet, dhe krimi i organizuar
11	Pengesat për biznese	Biznesi i humbur nga institucionet që nuk punojnë, mungesa e infrastrukturës, qasja e kufizuar në financa, shkathhtësitë e kufizuara në dispozicion, standarde të ulëta të prodhimit, mungesë e praktikave për sigurim të cilësisë, etj. siç është përcaktuar nga hulumtimi.
12	Konkurrenca e bizneseve serbe	Konkurrenca e bizneseve serbe në ekonominë e përgjithshme të Kosovës krahasuar me bizneset shqiptare
13	Integrimi në tregun e Kosovës	Shkalla e pjesëmarrjes së bizneseve Serbe-K në tregun e përgjithshëm të Kosovës, që i pranojnë institucionet e Kosovës që kanë të bëjnë me tregun
14	Funksionimi i institucioneve Qeveritare	Ekzistenca, efektshmëria dhe efikasiteti i institucioneve të Qeverisë së Kosovës
15	Besimi ndërmjet grupeve etnike	Niveli i besimit në mes të grupeve etnike në nivel komuniteti.
16	Ndikimi i strukturave paralele serbe	Niveli i ndikimit të strukturave paralele serbe që mund të ushtrohet mbi popullatën dhe bizneset.

Në mënyrë që të përcaktohet nëse një variabël e zgjedhur e mbulon tërë sistemin në çdo mënyrë, është bërë një vlerësim i variablave të përcaktuara. Kështu që janë marrë parasysh pesë domenet: shoqëria, politika, biznesi/ekonomia, institucionet, sektori joformal. Të gjitha variablat janë vlerësuar në lidhje me mbulimin e domeneve. Është paraqitur rezultati i vlerësimit të relevancës. Përveç kësaj, është paraqitur cilat variabla kanë ndikim jashtë sistemit dhe cilat variabla ndikohen nga jashtë. Mund të shihet se variablat janë të shpërndara mirë, duke i mbuluar të gjitha domenet deri në një masë. Efektet nga jashtë janë më të mëdha se efektet jashtë. Këto efekte nga jashtë janë marrë parasysh kur janë interpretuar rezultatet e analizës.

Tabela 2: Vlerësimi i relevancës së setit të variablave

		Shoqëria	Politika	Biznesi/ Ekonomia	Institucionet	Sektori joformal	Ndikimi jashtë	Të ndikuara nga jashtë
1	Besimi në institucionet e Kosovës	x	x		X			
2	Pranimi i statusit politik	x	x		X		x	X
3	Zbatimi i ligjit			x	X	x		X
4	Presioni nga shoqëria	x	x			x		
5	Politika anti-integruese	x	x				x	x
6	Politika pro-integruese	x	x				x	x
7	Performanca ekonomike			x	X	x		x
8	Izolimi i komunitetit serb	x	x					
9	Niveli i bashkëpunimit	x		x		x		
10	Konkurrenca e padrejtë			x	X	x		
11	Pengesat për biznes			x	X	x		
12	Konkurrenca e bizneseve serbe			x	X			
13	Integrimi në tregun e Kosovës		x	x	X			
14	Funksionimi institucioneve Qeveritare		x		X			
15	Besimi në mes grupeve etnike	x	x					
16	Ndikimi i strukturave paralele serbe		x		X	x		x
	Shuma	8	10	7	10	7	3	6

2.2.3 Analiza e ndjeshmërisë

Në analizën e ndjeshmërisë, ndikimi i secilës variabël në çdo variabël tjetër u përcaktua në diskutimin në ekip. Qëllimi ishte të bëhet kjo në mënyrë sa më objektive, duke u bazuar në të dhënat e mbledhura. Është me rëndësi të përmendet se këto ndikime ende mbasin subjektive deri në një masë dhe me siguri do të dalin vlerësime tjera me rezultate të ndryshme. Kjo, megjithatë, varet nga sistemet komplekse.

Shuma e të gjitha ndikimeve të një faktori specifik në të gjithë faktorët tjerë e përcakton nivelin e tij të veprimit, d.m.th. sa ndikon në sistem, shuma e të gjitha ndikimeve të një faktori specifik në nivelin e tij pasiv, d.m.th. sa ndikohet nga sistemi. Duke u bazuar në aktivitetin dhe pasivitetin e tyre, variablat mund të karakterizohen si aktive, kritike, pasive dhe në pritje.


Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë mund të përdoren për të kuptuar ndikimin relativ të variablave të ndryshme. Matrica e ndikimit që i reflekton të gjitha ndikimet është e paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 3: Matrica e ndikimit

		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	
	Variablat	Besimi në institucionet e Kosovës	Pranimi i statusit politik	Zbatimi i ligjit	Presioni i shoqërisë	Politikat anti-integruese	Politikat pro-integruese	Performanca ekonomike	Izolimi i komunitetit serb	Niveli i bashkëpunimit	Konkurrenca e padrejtë	Pengesat për biznese	Konkurrenca e bizneseve serbe	Integrimi në tregun e Kosovës	Funksionimi i institucioneve Qeveritare	Besimi ndërmjet grupeve etnike	Ndikimi i strukturave paralele serbe	Aktiviteti
1	Besimi në institucionet e Kosovës		3	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	2	3	12
2	Pranimi i statusit politik	0		1	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	3	9
3	Zbatimi i ligjit	3	0		0	0	0	3	3	0	3	3	2	0	2	0	2	21
4	Presioni i shoqërisë	0	0	0		0	0	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0	3
5	Politikat anti-integruese	2	3	0	3		0	0	2	0	0	0	0	0	0	3	3	16
6	Politikat pro-integruese	1	3	0	0	0		0	3	0	0	0	0	0	0	3	2	12
7	Performanca ekonomike	3	0	0	0	0	2		0	3	0	0	0	0	0	0	0	8
8	Izolimi i komunitetit serb	2	2	0	2	2	2	1		3	0	1	3	1	0	2	2	23
9	Niveli i bashkëpunimit	0	0	0	0	2	2	3	0		0	0	1	3	0	2	0	13
10	Konkurrenca e padrejtë	3	0	0	0	2	0	3	0	0		0	2	0	0	2	0	12
11	Pengesat për biznese	0	0	0	0	0	0	3	0	3	0		3	0	0	0	0	9
12	Konkurrenca e bizneseve serbe	0	0	0	0	0	0	2	0	2	0	0		3	0	0	0	7
13	Integrimi në tregun e Kosovës	0	0	0	2	3	2	3	2	0	0	0	0		0	3	1	16
14	Funksionimi i institucioneve Qeveritare	3	0	3	0	0	2	2	2	0	3	3	0	0		1	2	21
15	Besimi ndërmjet grupeve etnike	0	3	0	3	1	0	0	3	2	0	0	0	0	0		2	14
16	Ndikimi i strukturave paralele serbe	0	3	2	0	3	2	0	3	0	0	0	0	0	2	2		17
	Pasiviteti	17	17	7	13	13	12	20	18	16	6	7	11	10	6	20	20	213

Duke u bazuar në aktivitetet dhe pasivitetet e kalkuluar në matricën e ndikimit, u paraqit diagrami i ndikimit. Në diagramin e ndikimit (Figura 9), secila variabël është plotësuar me aktivitetin në boshin y dhe pasivitetin në boshtin x.

Figura 9: Diagrami i ndikimit



Burimi: Analiza e sistemit

Diagrami i ndikimit është i ndarë në katër katrorë duke e përdorur aktivitetin dhe pasivitetin mesatar përkatës. Variablat karakterizohen si aktive, kritike, në pritje, apo pasive varësisht nga hapësira në diagram. Tabela 4 i rankon variablat më aktive dhe ato më pasive. Megjithatë nuk mund të ndikohen të gjitha variablat nga akterët e sistemit. Tabela 5 interpreton karakteristikat e variablave dhe përcakton nëse është e mundur të ndikohet në to.

Tabela 4: Rankimi i variablave në bazë të aktivitetit dhe pasivitetit të tyre përkatës

Ranku		Aktiviteti	Pasiviteti	
	Nr	Variabla	Nr	Variabla
1	8	Izolimi i komunitetit serb	15	Besimi në mes grupeve etnike
			16	Ndikimi i strukturave paralele serbe
			7	Performanca ekonomike
2	14	Funksionimi i institucioneve Qeveritare		
2	3	Zbatimi i ligjit		
4	16	Ndikimi i strukturave paralele serbe	8	Izolimi i komunitetit serb

Tabela 5: Interpretimi i diagramit të ndikimit dhe mundësia e ndikimit në variabla

No	Variable	Interpretation
Aktive Variablat aktive kanë ndikim të madh në sistem por ndikohen dobët nga ai. Ato janë leverages kritik dhe mund të përdoren për të ndikuar në sistem.		
3	Zbatimi ligjit	Një ligj funksional që zbatohet pa dyshim se ka ndikim të madh në sistem. Ligji është parakusht për tregje funksionale dhe për parandalimin e dështimit të tregut duke krijuar siguri të kontratave dhe mundësi për ta zbatuar ligjin përmes gjykatave; ai ofron siguri për të investuar në aktivitete të ardhshme të biznesit dhe zgjerim. Ai është edhe bazë për lirinë e lëvizjes dhe sigurinë për të gjithë njerëzit. Një ligj funksional nuk ndikohet shumë nga pjesa tjetër e sistemit pasi që është diçka që duhet të zbatohet nga Qeveria përmes institucioneve si gjykatat dhe policia. <i>Kjo variabël mund të ndikohet nga masat e politikave.</i>
5	Politikat anti-integruese	Politikat anti-integruese drejtohen fuqishëm nga pjesa e komunitetit serb që është i orientuar nga Serbia. Ndikimi i kësaj variabël është i madh pasi që e formëson komunitetin serb. Ajo duhet të merret parasysh kur dëshirojmë ta ndryshojmë sistemin pasi që është variabël që mund të kontribuojnë në rezistencën e sistemit për të ndryshuar, siç mund të shihet edhe në analizën e zbrazëtive në vijim. Kjo variabël është në kufi të katrorit kritik. Rrjedhimisht, ajo paraqet rrezik që i kontribuon sjelljes së pakontrolluar të sistemit. <i>Në këtë variabël është vështirë të ndikohet edhe nga ana politikave edhe nga ana e donatorëve ndërkombëtar.</i>
13	Integrimi në tregun e Kosovës	Integrimi i bizneseve në tregun e Kosovës mund të ketë ndikim të madh në tërë sistemin. Megjithatë, integrimi nuk mund të ndikohet drejtpërdrejtë dhe është pronë që del nga sistemi. Në sistemin tonë ajo është më së afërmi asaj që do ta quanim variabël e synuar, d.m.th. variabël që synohet për tu rritur nga intervenimet e projekteve. <i>Nuk ka mundësi për ndikim të drejtpërdrejtë.</i>
14	Institucionet Qeveritare Funksionale	Me aktivitetin siç është ligji⁸, funksionimi i institucioneve qeveritare është element aktiv i sistemit. Qeveria e Kosovës mund ta ftojë besimin e komunitetit serb për t'i përfshirë kompanitë e tyre në tregun e Kosovës vetëm me institucione funksionale dhe kredibile. Për më tepër, institucionet funksionale nënkuptojnë më pak burokraci, më pak shirit të kuq, procedura më të lehta, etj. <i>Kjo variabël mund të ndikohet nga masat e politikave.</i>
Kritike Këta faktorë kanë ndikim të madh në sistem dhe ndikohen shumë nga ai. Ata janë shtytësit dhe katalizatorët e sistemit. Një karakteristikë qendrore e variablave kritike është se ndryshimet në këto variabla me siguri do të reflektojnë në vetë variablat. Në çfarë mënyre bëhet kjo duhet të përcaktohet nga analiza e zbrazëtive të informatës kthyese. Kur ndikohet në to, duhet të jemi të vetëdijshëm për rrezikun e tej-ngrohjes së sistemit nga ndërhyrja në zbrazëtitë pozitive të informatës kthyese.		
8	Izolimi i komunitetit serb	Izolimi i komunitetit serb ka pasivitet që e tejkalon mesataren, d.m.th. ndikohet shumë në masë të madhe nga sistemi. Në të njëjtën kohë, është variabla më aktive nga të gjitha, d.m.th. ajo ka edhe ndikim të madh në sistem. Kjo është një variabël që ka shumë potencial si pikë hyrëse. <i>Variabla përbëhet nga shumë aspekte ku shumica mund të ndikohen edhe nga masat e politikave edhe nga projektet e udhëhequra nga donatorët.</i>
9	Niveli i bashkëpunimit	Niveli i bashkëpunimit është variabël në kufi të të qenit kritik dhe pasiv. Ndikohet relativisht shumë nga sistemi por nuk ndikon në sistem sa variablat tjera kritike apo aktive. Kjo sugjeron se një qasje indirekte për ta ngritur bashkëpunimin do të ishte më e suksesshme në periudhë afat-gjatë. <i>Kjo variabël mund të synohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga intervenimet apo indirekt dhe në një mënyrë më sistematike duke ndikuar në sistem ashtu që niveli i bashkëpunimit të rritet në mënyrë që qëndrueshme.</i>


8 Në aspekt teknik, ligji është gjithashtu institucion. Por pasi që është përmendur ndaras disa here, për këtë analizë është marrë parasysh që të ketë një variabël të ndarë.

15	Besimi në mes grupeve etnike	Besimi në mes grupeve etnike është në mesin e variablave më pasive të sistemit, edhe pse ende shfaq aktivitet mbi mesatare. Ajo është më pak aktive se izolimi i komunitetit serb, d.m.th. shfaq rol më pak të plotë në ndryshimin e sistemit. <i>Besimi është aspekt emergjent i një sistemi shoqëror dhe është vështirë të ndikohet në të përmes ndryshimeve të politikave apo intervenimeve të donatorëve. Disa projekte janë përpjekur të themelojnë platforma për ndërtimin e besimit, që mund të shihen si qasje e mundshme.</i>
16	Ndikimi i strukturave paralele serbe	Është interesant se ndikimi i strukturave paralele serbe gjithashtu shfaq karakteristika kritike. Kjo është kryesisht për shkak se ndikimi i tij varet shumë nga performanca dhe pranimi i Qeverisë dhe institucioneve të Kosovës si edhe niveli i izolimit dhe ndikimi i politikave anti-integruese. Në të njëjtën kohë, strukturat paralele ndikohen shumë nga sistemi kryesisht për shkak se u paguan paga një numri të serbëve dhe gjithashtu ndikojnë në politika anti-integruese. <i>Ndikimi i strukturave paralele serbe vështirë se mund të ndryshohet nga masat e politikave apo intervenimet e donatorëve pa rrezikuar ndryshim të dukshëm dhe të paparashikuar në sistem siç është dëshmuar për shembull në Veri të Kosovës në vitin 2011.</i>
Pasive Këta faktorë kanë ndikim të dobët në sistem por ndikohen shumë nga ai. Ata mund të shihen si indikatorë. Megjithatë, duhet ta marrim parasysh se grupi jonë i variablave është zgjedhje e variablave më relevante, dhe rrjedhimisht është grup i variablave që shprehin në përgjithësi aktivitet të lartë në sistem në përgjithësi. Ajo që është përcaktuar nga kjo analizë është thjesht statusi i tyre relativ ndaj variablave tjera në grup. Rrjedhimisht, nga natyra e zgjedhjes së tyre, të gjitha variablat paraqesin ndikim të caktuar në sistem në përgjithësi dhe variablat pasive gjithashtu nuk duhet të lehet anash si pika të mundshme hyrëse.		
1	Besimi në institucionet e Kosovës	Rëndësia e kësaj variabile qëndron në diskutimin për pranimin e Shtetit të Kosovës nga popullata serbe e Kosovës. Vetëm nëse kanë besim të mjaftueshëm në institucionet e Kosovës mund të jenë të gatshëm ta pranojnë statusin politik të Kosovës dhe ta reduktojnë ndikimin e strukturave paralele. <i>Kjo variabël është indikator i mirë për ta vlerësuar gatishmërinë e serbëve-K për tu integruar në strukturat e reja. Ndërtimi aktiv i besimit mund ta përkrahë këtë.</i>
2	Pranimi i statusit politik	Pranimi i statusit politik nga shumica shihet si parakusht për institucione plotësisht funksionale dhe zbatim të ligjit, sidomos për shkak të mungesës së qartësisë momentale se cilën kornizë ligjore dhe cilat institucione i pranojnë njerëzit. <i>Kjo është pronë emergjente e sistemit dhe nuk mund të ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë.</i>
7	Performanca ekonomike	Performanca ekonomike i ka marrë karakteristikat e saj pasive në këtë sistem për shkak se aktiviteti i saj drejtohet kryesisht nga niveli i bashkëpunimit. Aty, megjithatë shfaq ndikim të madh. <i>Nëse kjo variabël shfrytëzohet si indikator, duhet të ndahet nga ndikimi i bashkëpunimit dhe ndikimit të jashtëm në ekonomi.</i>
Në pritje Këta faktorë kanë ndikim të dobët në sistem dhe ndikohen pak nga ai. Ata kryesisht shihen si stabilizatorë të sistemit.		
4	Presioni nga shoqëria	Variablat në pritje as nuk kanë ndikim të madh në sistem e as nuk ndikohen shumë nga sistemi. Nga grupi i variablave, konkurrenca e padrejtë është më aktive, së bashku me politikat pro-integruese. Ato megjithatë shfaqin një aktivitet të ulët në krahasim me variablat tjera dhe prandaj edhe nuk janë zgjedhja e parë e synimeve të intervenimeve. Edhe pse presioni i shoqërisë emërohet nga shumica si faktor vendimtar, edhe sondazhi e edhe diskutimet e ndryshme me menaxherë të ndryshëm të bizneseve treguan se ndikimi i tij është shumë i kufizuar, nëse ka ndonjë. Gjithashtu konkurrenca e bizneseve serbe nuk duket si brengë primare, sidomos për shkak të numrit të vogël të bizneseve serbe; nuk do të kishte ndikim të madh në sistem në përgjithësi.
6	Politika pro-integruese	
10	Konkurrenca e padrejtë	
11	Pengesat për biznes	
12	Konkurrenca e bizneseve serbe	

2.2.4 Analiza e zbrazëtive

Në analizën e zbrazëtive, matrica e ndikimit është paraqitur në mënyrë vizuale, d.m.th. ndikimi në mes të variablave është paraqitur me shigjeta. Pasi që paraqitja e të gjitha ndikimeve në këtë sistem kompleks nuk do të paraqiste shumë qartësi, janë paraqitur vetëm ndikimet më të mëdha (vlera 3) në Figurën 10.

Figura 10: Diagrami i zbrazëtive të informatës kthyesë




Burimi: Analiza e sistemit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është gjetja e mënyrave për ta nxitur integrimin e bizneseve të serbëve-K në tregun e Kosovës. Figura 11 paraqet trungun e shkakut për këtë variabël, d.m.th. si ndikohet kjo variabël. Ekzistojnë tri mënyra. E para është të bëhen bizneset e serbëve-K më konkurruese për të konkurruar me kompanitë tjera në tregun e Kosovës. Siç shihet më lart, konkurrenca e bizneseve serbe është vetëm variabël në pritje me shumë pak ndikim në sistem.

Mënyra e dytë është të ngritet bashkëpunimi me bizneset e shqiptarëve-K. Kjo mund të bëhet drejtpërdrejtë duke e inkurajuar bashkëpunimin, për shembull me grante apo kredi të kushtëzuara. Megjithatë, një zgjidhje më sistematike do të ishte të arrihet ky qëllim në mënyrë indirekte, për shembull duke e reduktuar 'Izolimin e komunitetit serb', një variabël kritike që ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e bashkëpunimit.

Faktori i tretë që ndikon në integrim është besimi në institucionet Qeveritare. Dy variabla aktive mund të ndikohen në trungun e shkakut për ta ngritur besimin në institucionet qeveritare. Ato janë 'Zbatimi i ligjit' si edhe 'Funksionimi i institucioneve qeveritare'. Rrjedhimisht, këto dy variabla janë pikat primare të hyrjes për intervenimet e politikave.

Figura 11: *Trungu i shkakut për integrim ne tregun e Kosovës*




Burimi: Analiza e sistemit

Ekzistojnë dy zbrazëti të informatës kthyesë që janë të ndërlidhura me dy rrugët e para të ndikimit, një është zbrazëtiia përforcues, dhe tjetra është zbrazëtiia frenuese, të ilustruara me shigjetat e kaltra në Figurën 10. Dinamika e këtyre dy zbrazëtiive parashikon që sistemi është relativisht stabil pa ndonjë ndryshim të madh. Nëse zbrazëtiia përforcues e rrit integrimin në tregun e Kosovës, zbrazëtiia tjetër e vë në pritje këtë lëvizje.

Gjithsej 9 variabla janë të përfshira drejtpërdrejt në zbrazëti. 8 variablat tjera të modelit ndikojnë në zbrazëti nga jashtë, të ilustruara me shigjetat e gjelbra. Disa nga këto variabla janë sërish të ndërlidhura.

Figura 12: *Zbrazëtiitë përforcuese*



Burimi: Analiza e sistemit

Figura 12 paraqet zbrazëtitë përforcuese të informatës kthyesë. Për ta thjeshtuar ilustrimin më tej, rruga drejt 'Konkurrenca e bizneseve serbe' nuk është e paraqitur pasi që nuk konsiderohet si vendimtare.


Kjo zbrazëti na tregon se *niveli i rritur i bashkëpunimit* çon drejt integritit të rritur në tregun e Kosovës. Integrimi më i madh në tregun e Kosovës çon drejt performancës së rritur ekonomike, duke çuar sërish drejt *nivelet të rritur të bashkëpunimit*. Për më tepër, integrimi i lartë në tregun e Kosovës gjithashtu çon drejt besimit të rritur në mes të komuniteteve etnike, që çon drejtpërdrejt dhe përmes zvogëlimit të izolimit të komunitetit serb drejt *nivelet të rritur të bashkëpunimit*.

Figura 13 paraqet zbrazëtitë frenuese të informatës kthyesë, sërish duke mos marrë parasysh rrugën drejt konkurrencës së bizneseve serbe. Edhe presioni nga shoqëria nuk është paraqitur pasi që është vlerësuar si variabël në pritje si edhe rrjedhimisht me më pak ndikim.

Në këtë rast, *integrimi i shtuar* në tregun e Kosovës çon drejt përpjekjeve të rritura të politikës anti-integruese për ta kundërshtuar këtë zhvillim. Prandaj kjo çon drejt ndikimit të shtuar të strukturave paralele serbe, që sërish shton izolimin e komunitetit serb, duke e zvogëluar nivelin e bashkëpunimit dhe eventualisht çon drejt *nivelet të zvogëluar të integritit*.

Vëreni se ekziston një zbrazëti e vogël frenuese në këtë grupacion, d.m.th. përforsim i politikave anti-integruese dhe ndikimi i strukturave paralele serbe.

Figura 13: Zbrazëtitë frenuese




Analiza e sistemit

2.2.5 Zgjedhja e variablave për intervenim

Siç është paraqitur përmes ndjeshmërisë dhe analizës së zbrazëtitë, variablat që kanë më së shumti probabilitet të çojnë drejt ndryshimeve janë [1] 'Niveli i bashkëpunimit', [2] 'Funksionimi i institucioneve Qeveritare' dhe [3] 'Zbatimi i ligjit'. Ndryshimet nga dy të fundit arrihen më së miri në nivel të politikave, niveli i bashkëpunimit, siç është përmendur më parë, rritet më së miri në mënyrë indirekte.

Figura 14: *Trungu i shkakut për nivelin e bashkëpunimit*



Burimi: Analiza e sistemit

Figura 14 paraqet trungun e shkakut për variablën ‘Niveli i bashkëpunimit’. Pikat kryesore hyrëse që marrin parasysh analizën e ndjeshmërisë janë izolimi i komunitetit serbe si edhe ‘Performanca ekonomike’. ‘Pengesat për biznes’ është variabël në pritje por megjithatë me aktivitet relativisht të lartë dhe mund të merret parasysh si shtesë. ‘Presioni i shoqërisë’ në anën tjetër nuk shihet se ka mjaft ndikim për të bërë ndonjë ndryshim dhe do të ishte edhe më tej e vështirë të ketë ndikim.

Izolimi i komunitetit serb, siç është paraqitur më lart, është variabël kritike si edhe variabla me aktivitetin më të lartë të sistemit. Andaj është një pikë shumë logjike dhe e dukshme për intervenim. Të gjitha variablat prioritarë për intervenim janë të listuara në Tabelën 6.

Tabela 6: Variablat prioritarë për intervenim të identifikuar nga SDA

Nr	Variabla	Lloji
9	Niveli i bashkëpunimit	Kritik
14	Funksionimi i institucioneve Qeveritare	Aktiv
3	Zbatimi i ligjit	Aktiv
8	Izolimi i komunitetit serb	Kritik
7	Performanca ekonomike	Pasiv
11	Pengesat për biznes	Në pritje

Duke i ngritur tri variablat 'Izolimi i komunitetit serb', 'Perfor- manca ekonomike' dhe 'Pengesat për biznes' fuqizohet zbrazëtia përforcuese. Por në mënyrë që intervenimet të bëhen të qën- drueshme dhe efektive, edhe zbrazëtia frenuese duhet të merret parasysh. Variablat kryesore në zbrazëtinë frenuese janë 'Politika anti-integruese' si edhe 'Ndikimi i strukturave paralele serbe'. Të dy variablat kanë aktivitet të lartë dhe prandaj janë në gjendje të ndikojnë në masë të madhe në sistem. Ndikimi i strukturave paralele serbe gjithashtu ka pasivitet relativisht të lartë që e bën atë variabël kritike. Nëse kthehemi te matrica e ndikimit mund të shohim se variablat që ndikojnë në njërin apo të dy variablat janë besimi në institucionet e Kosovës, siç është paraqitur në Figurën 9 si edhe pranimi i statusit, ligji dhe izolimi i komunitetit serb. Kjo e konfirmon sërish domosdoshmërinë për ta provuar ndikimin e variablave 'Zbatimi i ligjit' dhe 'Izolimi i komunitetit serb'.

2.2.6 Perspektivat

Një aspekt tjetër që duhet të merret parasysh kur shikohet një sistem kompleks janë perspektivat e ndryshme të akterëve. Kjo është një pjesë e rëndësishme e analizës së akterëve të ADS. Dy aspektet më të shpeshta që përmenden nga cilado anë, d.m.th. nga ana serbe dhe shqiptare përmenden këtu dhe analizohen duke u bazuar në gjetjet nga analiza e sistemeve.

Këto dy perspektiva mund të shprehen lehtë nga dy fraza tër- heqëse, edhe pse natyrisht në realitet shprehen në mënyrë më një-anësore:

Perspektiva e serbëve-K: "Shqiptarët nuk dëshirojnë të bëjnë biznes me ne edhe pse prodhimet tona janë konkurruese edhe me çmim edhe me cilësi. Ata nuk duan zhvillim ekonomik për serbët."

Shqiptarët-K: "Etnija nuk është problem, ne i trajtojmë të gjithë njerëzit njëjtë kur bëhet fjalë për biznes."

Pa dyshim se këto deklarata nuk e shprehin realitetin e vëzh- guar. Megjithatë, perspektiva na ofron gjetje të rëndësishëm për atë se si e perceptojnë komunitetet njëri-tjetrin dhe duke u bazuar në perspektiva, mund të propozohet një arsyetim për sjelljen e shfaqur nga komunitetet. Për shembull perspektiva e serbëve-K e arsyeton aspektin e izolimit dhe madje kthehet në izolim të qëllimshëm të pranuar nga shqiptarët. Në anën tjetër, atë të shqiptarëve-K, bashkëpunimi përmendet si diçka shumë normale, që padyshim nuk është aq normal kur shikohet realiteti. Shumë biznese të serbëve-K, për arsye të ndryshme, nuk e kanë të lehtë t'i shesin prodhimet e tyre në tregun e Kos- ovës.

Një parim thelbësor i të gjitha strategjive për arritjen e një ndryshimi të qëndrueshëm në sisteme komplekse është lehtësimi i ndryshimit nga brenda. Kjo, për shembull, mund të arrihet duke i fuqizuar marrëdhëniet në mes të bërësve të ndry- shimeve në të dy anët apo në mes të atyre që punojnë drejt një qëllimi plotësues dhe i lejon ata të arrijnë deri te zgjidhjet e tyre për bashkëpunim.

Një parim thelbësor për negocimin e ndryshimit është vlerësimi i pozitës dhe perspektivës së njëri-tjetrit. Kjo duhet të merret parasysh kur dizajnohen strategji intervenimi.

2.2.7 Modelet dhe intervenimet e mundshme

Siç është shpjeguar më parë, strategjia për të sjellë ndryshim në sisteme komplekse është e bazuar në dallimin e modeleve në sistem dhe zbulimi i shkaktarëve të tyre të brendshëm. Mod- elet që janë të favorshme do të fuqizohen dhe modelet që puno-jnë kundër ndryshimit të përcaktuar do të dobësohen.

Qëllimi i ADS është ta përshkruajë sistemin në mënyrë që t'i bëjë modelet e dukshme dhe të qasshme. Megjithatë, disa modele shprehen më mirë përmes qasjeve narrative, kryesisht intervistave sy-më-sy me njerëz të ndryshëm. Një numër mode-lesh i bazuar në tregimet që i kanë treguar të intervistuarit janë të prezantuara në Tabelën 7 së bashku me raportin e tyre ndaj qëllimit tonë, intervenimet e mundshme dhe një shpjegim se si rezonojnë ato me modelin tonë të sistemit.

Tabela 7: Modelet që janë bërë të dukshme gjatë analizës dhe si mund të shfrytëzohen.

Modeli	Raporti ndaj qëllimit tonë	Intervenimet e mundshme	Perspektiva e sistemit
Bashkëpunimi i suksesshëm në mes të bizneseve të serbëve-K dhe shqiptarëve-K.	I favorshëm	Programi i cili në mënyrë të sistematike i fuqizon modelet e biznesit në të cilat bashkëpunimi shihet shpesh, d.m.th. në sektorët ku bizneset e serbëve-K janë aktive. Bashkëpunimi ekzistues duhet të fuqizohet dhe duhet të nxiten bashkëpunime të reja.	Ky intervenim duhet të ketë ndikimi në variablat ‘Niveli i bashkëpunimit’, ‘Konkurrenca e bizneseve serbe’ dhe eventualisht në variabilën ‘Performanca ekonomike’. Të gjitha variablat janë pjesë zbrazëtisë përforcuese të informatës kthyesë dhe dy nga to janë identifikuar më lart si variabla prioritare për intervenime.
Grupe të prodhuesve të organizuar mirë dhe kompani mirë të themeluara në hapësirën e serbëve-K janë duke pritur për të filluar bashkëpunimet por nuk janë të lidhur mirë me bizneset e shqiptarëve-K.	I favorshëm	Fuqizimi i rrjeteve të kompanive të serbëve-K dhe shqiptarëve-K. Themelimi i asociacioneve të përbashkëta të biznesit, platforma ku bizneset mund të takohen, panaire tregtie, etj. Kjo linjë intervenimi do të ishte veçanërisht e rëndësishme për t’i testuar deklaratat e dy komuniteteve që do të përshkruheshin në pjesën për perspektiva më lart.	Intervenimi do të kishte ndikim në variablën ‘Izolimi i komunitetit serb’ nga perspektiva e biznesit që çon drejt ngritjes së nivelit të bashkëpunimit si edhe konkurrencës së bizneseve serbe, duke e fuqizuar zbrazëtinë përforcuese. Izolimi i komunitetit serb është identifikuar si variabël prioritare për intervenim.
Aktivitete për zhvillimin ekonomik të Komunës së Shtërpces.	I favorshëm	Fuqizimi i kapaciteteve të komunave për zhvillim lokal ekonomik si në aspekt të shkathtësive ashtu edhe të burimeve.	Ky intervenim do të kishte ndikim në variablën ‘Konkurrenca e bizneseve serbe’ nëse zbatohet kryesisht në komunat serbe dhe në ‘Performanca ekonomike’ nëse përfshihen të gjitha komunat, sërish duke e fuqizuar zbrazëtinë përforcuese. Ajo që është e rëndësishme, do ta përmirësonte variablën ‘Besimi në institucionet e Kosovës’, pasi që Komuna e Shtërpces është një institucion i Qeverisë së Kosovës. Besimi në institucionet e Kosovës është i rëndësishëm për ta reduktuar ndikimin e zbrazëtisë frenuese të informatës kthyesë.
Izolimi i komunitetit (të biznesit) të serbëve-K, vështirësitë për t’iu qasur tregjeve, mungesa e rrjeteve, perceptimi për cilësi të ulët të prodhimeve.	I pafavorshëm	Synimi i veçantë i i izolimit të komunitetit serb duke e përkrahur komunikimin në mes të komuniteteve etnike dhe duke i fuqizuar politikat integruuese të qeverisë.	Ky intervenim do të kishte ndikim në variablën prioritare ‘Izolimi i komunitetit serb’ edhe nga perspektiva shoqërore edhe ajo e biznesit.

Konkurrenca e ulët e bizneseve serbe dhe atraktiviteti i ulët si partner biznesi apo furnizues për shkak të madhësisë së vogël, praktikave tradicionale, etj. Shkathtësitë e dobëta të menaxhimit të biznesit dhe nepotizmi në tërë vendin është duke i bërë kompanitë më pak eficiente.	I pafavorshëm	Intervenimet i ngrisin të NVM-te qoftë në mënyrë sistematike për tërë Kosovën me veprime afirmative për bizneset e serbëve-K duke i synuar konkurrencën e bizneseve të serbëve-K si edhe performancën ekonomike në përgjithësi.	Ky intervenim do të ketë ndikim në variablat 'Niveli i bashkëpunimit' dhe në variablën prioritare 'Performanca ekonomike'. Të dy variablat janë pjesë e zbrazëtisë përforcuese të informatës kthyese.
Intervistat tregojnë se ka instanca të institucioneve qeveritare që janë diskriminuese ndaj serbëve-K duke mos i pranuar dokumentet dhe formularët në gjuhën serbe apo duke refuzuar të flasin në gjuhën serbe gjatë komunikimit personal. Mungesa e qeverisjes së hapur dhe transparente çon drejt vendimeve që preferojnë komunitetin e vet dhe rrjedhimisht çojnë drejt diskriminimit të etnive tjera.	I pafavorshëm	Zbatimi i politikave për ta përmirësuar qeverisjen e mirë dhe transparencën e vendim marrjes në institucionet Qeveritare.	Ky intervenim do të kishte ndikim në variablën 'Funksionimi i institucioneve Qeveritare', 'Besimi në institucionet qeveritare' si edhe 'Zbatimi i ligjit', të gjitha ndihmojnë ngritjen e integritetit të bizneseve shërbejnë në tregun e Kosovës, nga të cilat dy janë variabla prioritare. Variabla 'Besim në institucionet Qeveritare', si edhe dy variablat tjera në mënyrë indirekte janë variabla të rëndësishme për ta reduktuar ndikimin e strukturave paralele serbe dhe në këtë mënyrë për ta reduktuar ndikimin e zbrazëtisë frenuese të informatës kthyese.
Nuk ka siguri për kontrata, shumë mosmarrëveshje në lidhje me të drejtat mbi pronën të pazgjidhura, etj. Krimi i organizuar dhe konkurrenca e padrejtë po e vështirësojnë biznesin.	I pafavorshëm	Zbatimi i politikave për ta përmirësuar ligjin dhe funksionimin e institucioneve të policisë dhe gjyqësorit siç janë gjykatat.	Ky intervenim do të kishte ndikim në variablën 'Besimi në institucionet qeveritare' si edhe në 'Zbatimi i ligjit', të dyja ndihmojnë në ngritjen e integritetit të bizneseve serbe në tregun e Kosovës. Variabla 'Besimi në institucionet Qeveritare' si edhe në mënyrë indirekte zbatimi i ligjit janë variabla të rëndësishme për ta reduktuar ndikimin e strukturave paralele serbe dhe në këtë mënyrë ta reduktojë ndikimin e zbrazëtisë frenuese të informatës kthyese.

Referencat

- AMCHAM. 2008. *Ndikimi i Korrupsionit në komunitetin e biznesit të Kosovës*. Nëntor, 2008
- Androsik, A. 2007. *Siguria humane dhe fuqizimi ekonomik. Përfaqësimi multi-etnik i grave në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Raste të zgjedhura nga Kosova*. Studime Transkulturore, 2-3 (2006-2007), fq.109-121
- CBK. 2010. *Raporti Vjetor 2010*. Prishtinë: Banka Qendrore e Kosovës.
- C. F. Kurtz dhe D. J. Snowden (2003): *Dinamika e re e strategjisë: Kuptimi i botës komplekse dhe të komplikuar*. Revista e Sistemeve IBM, Vol. 42, Nr. 3, fq. 462-483.
- Corbanese, V. & Rosas G. 2007. *Tranzicioni i të rinjve për punë të denjë: Dëshmi nga Kosova*. Gjenevë: ILO.
- Këshilli për Qeverisje Gjithpërfshirëse. 2010. *Ndërtimi i komunitetit të qëndrueshëm serb në Kosovë*. Raporti i Konferencës, Vienë, Austri
- Djukanovic, D. 2008. *Integrimi post-konfliktit i komuniteteve të pakicave etnike në Kosovë*.ETC HUMSEC Seria e Punimeve.
- Komisioni Evropian. 2011. *Kosovë 2011 Raporti i Progresit*. Bruksel: Komisioni Evropian.
- Komisioni Evropian. 2010. *Kosovë 2010 Raporti i Progresit*. Bruksel: Komisioni Evropian.
- Klubi për Politikë të Jashtme. 2011. Raporti i Progresit i Hartuar në Kosovë. 2011. Prishtinë Tetor, 2011
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave. 2011. *Kosova Veriore: Sovraniteti i Dyfishtë në Praktikë*.
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave. 2010. *Ligji në Kosovën e Pavarur*. Maj 19, 2010
- Fondi Monetar Ndërkombëtar. 2011. Republika e Kosovës: Deklarata Përmbyllëse e Nenit IV të Misionit Konsultativ 2011. Korrik 2011
- KFOS. 2010. *Reforma Lokale në Kosovë*. Shkurt, 2010.
- Iniciativa Kosovare për Stabilitet. 2009. Policy Briefs - Mitrovicë: Një Qytet, Dy Realitete. Dhjetor 2009
- OSBE. 2011. *Sistemi i Drejtësisë i Mitrovicës: Përditësim i Statusit dhe vazhdimësia e brengave për të drjetat e njeriut*. Janar, 2011.
- OSBE, 2007. *Strukturat Paralele në Kosovë 2006-2007*, 2007.
- P. Frischknecht dhe B. Schmied (2009): Umgang mit Umweltsystemen. *Methodik zum Bearbeiten von Umweltproblemen unter Berücksichtigung des Nachhaltigkeitsgedankens. Aktualisierte und überarbeitete Neuauflage*. OekomVerlag, München.
- Shaipi, K. 2008. *Ndikimi i korrupsionit në komunitetin e biznesit të Kosovës*. AMCHAM, Prishtinë
- Zyra e Statistikave të Kosovës. 2011. *Tregtia e Jashtme*
- UNDP. 2012. *Raporti për Zhvillim Njerëzor 2012*. Prishtinë 2012.
- Banka Botërore. 2011. *Kosovë "Zhvillimi i Biznesit 2011"*. Washington D.C.

Shtojcat

Shtojca 1 – Lista e Intervistave me Informatorët Kyç (KII)

Data	Institucioni/Organizata	Roli	Emri dhe Mbiemri
9/5/2011	SME Agjencia për Përkrahje / Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Shef i Divizionit për Përkrahje të Biznesit	Xhemajl Syla
9/5/2011	Avenija	Drejtor	Gordana Đorić
9/6/2011	Intercooperation	Menaxher i Projektit për Promovimin e Hortikulturës në Kosovë	Heini Conrad
9/7/2011	Fractal	Menaxher i Projektit	Milos Milovanovic
9/7/2011	Kuvendi Komunal Shtërpce	Drejtor i Divizionit për Zhvillim Ekonomik	Radoljub Mladenovic
9/7/2011	Komisioni Evropian	Udhëheqës Ekipi i Komisionit Evropian – Zhvillimi Ekonomik	Sirje Poder
9/7/2011	Intercooperation	Menaxher i Projektit – Qeverisja Lokale dhe Përkrahja e Decentralizimit (LOGOS)	Norbert Pijls
9/8/2011	Care	Drejtor i Programit	Dragan Peric
9/8/2011	Asociacioni i Biznesit të Kosovës	Drejtor Ekzekutiv	Lumnije Hajdini
9/13/2011	Oda Ekonomike Amerikane	Menaxher i Politikave	Arian Zeka
9/16/2011	Programi i Kosovës për Ndërmarrje Private	Menaxher i Programit për Zhvillimi të Biznesit dhe CFW	Burim Korqa
9/19/2011	Biznesmen shqiptar-K	Pestova	Bedri Kasumi
9/20/2011	Biznesmen serb-K		Mr. Nesovic
9/20/2011	Biznesmen serb-K	Pronar i Kompanisë LOLA FOT	Vukoje Vukojević
9/21/2011	Biznesmen serb-K	Pronar i Kompanisë Aqua Sana	Srećko Spasić
9/21/2011	Biznesmen serb-K	ROK (Pronar i Motelit-Restorantit)	Jovanovic Orli
9/23/2011	Oda Ekonomike e Kosovës	Drejtor i Departamentit për Analizë Ekonomike dhe Politika	Ardiana Gashi
12/6/2011	Biznesmen shqiptar-K	Pronar i Kompanisë Agro-Produkti	Naim Fejza
12/9/2011	Ekipi Komunal Përgaditor	Shef i MPT	Adrijana Hodzic
12/9/2011	UNDP	Menaxher i Projektit – Zhvillim i Bazuar në Rajon	Boban Simić



